



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

RAPORTI VJETOR 2025



PARANDALIMI
I KRIMIT FINANCIAR



ANALIZË
E AVANCUAR



BASHKËPUNIM
NDËRKOMBËTAR




QASJE E BAZUAR
NË RREZIK




PROFESIONALIZËM
DHE INTEGRITET





**Ky raport është një vlerësim i përpjekjeve të
përbashkëta për një sistem financiar të sigurt,
transparent dhe të qëndrueshëm.**

Falënderimet tona shkojnë për të gjithë partnerët,
të cilët me angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre
kontribuojnë në forcimin e sistemit parandalues si dhe
të integritetit financiar të ekonomisë sonë.



PËRMBAJTJA

SHKURTIMET	3
MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	4
MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR DHE URDHRA E BLOKIMIT TË PËRKOHSHËM	6
Urdhrat e bllokimit të përkohshëm	10
NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE DHE ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË	11
Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese	11
Analizimi i përputhshmërisë, inspektimet në vend dhe në distancë	13
MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCESET GJYQËSORE	15
Masat administrative	15
Ekzekutimi i Masave Administrative	17
Proceset gjyqësore	17
Koordinatori i të drejtës për informim	17
BASHKËPUNIMI KOMBËTAR	18
Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave	18
Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës	18
Përmbledhje e aktiviteteve të GTNP për vitin 2025	18
ZBATIMI I DOKUMENTAVE STRATEGJIK	22
Axxhenda e Reformave	22
Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit	22
Plani i Veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut për PP/FT (NRA)	24
Strategjia për edukimin e publikut mbi rrezikun e PP/FT në shoqërinë tonë	25
Ndjekja e Planit të Veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut për PP/FT (NRA)	25
Strategjia Institucionale e Agjencisë të Inteligjencës Financiare 2023–2027	26
Bashkëpunimi ndër-institucional	26
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	28
Shkëmbimi i informacioneve me NJIF	28
NDRYSHIME LIGJORE	30
BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE TI	31
Buxheti dhe menaxhimi i tij	31
Menaxhimi i burimeve njerëzore	31
TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	32
ANGAZHIMET NDËRINSTITUCIONALE	32
Aritjet më të rëndësishme gjatë vitit 2025:	32
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026	33
SHTOJCA I	34
TIPOLOGJI TË RASTEVE TË DËRGUARA NË ORGANET LIGJZBATUESE	34
Tipologji 1	34
Tipologji 2	36
Tipologji 3	38
Tipologji 4	40
Tipologji 5	42
Tipologji 6	43
Tipologji 7	44

SHKURTIMET

AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
AKKC	Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis
AKSK	Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike
AKSIK	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BE	Bashkimi Evropian
BSH	Banka e Shqipërisë
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
BMP	Bordi i Mbikëqyrjes Publike
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DHTIT	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Egmont	Rrjeti i Njërive të Inteligjencës Financiare në Botë
FATF	Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar
GIZ	Shoqata Gjermane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar
GTNP	Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës
IFJB	Institucion Financiar Jo-Bankë
KBLKPP	Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave
KiE	Këshilli i Evropës
KLGIJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
Moneyval	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
NjIF	Njësi e Inteligjencës Financiare
PEP	Person i Ekspozuar Politikisht
PP/FT/ADM	Pastrimi i Parave, Financimi i Terrorizmit dhe armët e dëmtimit në masë
PP	Prokuroria e Përgjithshme
OJF	Organizatë Jo-Fitimprurëse
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
RAD	Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë
SHKK	Shoqëri Kursim Krediti
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
SPAK	Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
ZKV	Zyrë Këmbimi Valutor
TI	Teknologjia e Informacionit

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

I nderuar lexues,

Kam kënaqësinë të prezantoj raportin vjetor të Agjencisë së Inteligjencës Financiare (AIF) për vitin 2025, i cili ofron një panoramë të plotë për veprimtarinë, sfidat dhe arritjet në forcimin e sistemit parandalues kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

Viti 2025 ishte një periudhë intensive, me fokus kryesor përgatitjen për raundin e 6-të të vlerësimit nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Evropës. Në rolin e koordinatorit kombëtar, AIF udhëhoqi një proces të gjerë ndërinstitucional, duke përfshirë plotësimin e pyetësorëve teknikë dhe të efektivitetit, ushtrime simuluese dhe trajnime të specializuara, të cilat kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional.

Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar mbetet një shtyllë kyçe e punës sonë. Koordinimi efektiv dhe shkëmbimi i informacionit kanë qenë vendimtarë në rritjen e efektivitetit të sistemit parandalues. Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës (GTNP) vijoi të luajë një rol kyç në koordinimin e politikave, shkëmbimin e informacionit dhe monitorimin e sistemit parandalues.

Gjatë vitit, GTNP u zgjerua me anëtarë të rinj dhe intensifikoi aktivitetet në mbështetje të prioriteteve kombëtare, përfshirë zbatimin e Strategjisë Kombëtare 2024–2030 dhe Vlerësimit Kombëtar të Riskut. Rritja e efikasitetit të GTNP ka kontribuar në përmirësimin e zbatimit të masave parandaluese, identifikimin e fushave prioritare, rritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve përkatëse dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat.

Në funksion të rritjes së ndërgjegjësimit publik dhe forcimit të bashkëpunimit me sektorin privat, AIF organizoi aktivitete edukimi financiar dhe zbatoi programin e integruar të trajnimeve, duke kontribuar në rritjen e njohurive dhe përputhshmërisë me kërkesat ligjore.

Në nivel ndërkombëtar, marrëdhëniet tona me njësitë homologe të inteligjencës financiare, si dhe me organizata si Moneyval, Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF) dhe Grupi Egmont, kanë qenë thelbësore në forcimin e rolit dhe besueshmërisë së AIF. Përmes pjesëmarrjes në konferenca, takime, trajnime dhe procese vlerësimi në fushën PPP/FT, kemi kontribuar në shkëmbimin e praktikave më të mira dhe në përvetësimin e përvojave ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2025, AIF zhvilloi takime me delegacione ndërkombëtare dhe u angazhua në aktivitete të shumta, duke rritur më tej bashkëpunimin dhe praninë ndërkombëtare. Mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë ka qenë thelbësore në forcimin e kapaciteteve tona institucionale dhe përgatitjen për proceset e monitorimit ndërkombëtar.

AIF kontribuon në forcimin e integritetit të sistemit financiar dhe në parandalimin e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit. Përmes analizës së inteligjencës, mbikëqyrjes së bazuar në rrezik dhe zbatimit efektiv të kuadrit rregullator, kemi synuar të rrisim përputhshmërinë dhe integritetin e sistemit parandalues. Në të njëjtën kohë, AIF ka vijuar me profesionalizëm funksionet e saj bazë, duke përfshirë analizën dhe dërgimin e rasteve të dyshimta, mbikëqyrjen dhe bashkëpunimin me autoritetet ligjzbatuese dhe rregullatore.

Gjatë vitit 2025, u forcua më tej bashkëpunimi me autoritetet kombëtare, organet e zbatimit të ligjit dhe institucionet rregullatore, me synim përmirësimin e shkëmbimit të informacionit dhe rritjen e efikasitetit operacional.

Duke parë përpara, viti 2026 pritet të sjellë sfida të reja, veçanërisht në vijim të procesit të vlerësimit të vendit nga Komiteti Moneyval. Në funksion të rritjes progresive dhe të qëndrueshme ndërinstitucionale, ftoj të gjitha institucionet publike dhe sektorin privat të thellojnë bashkëpunimin dhe të intensifikojnë masat kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

Në përfundim, ky raport është dëshmi e përpjekjeve të përbashkëta të AIF dhe partnerëve të saj. Shpreh mirënjohjen për stafin e AIF lidhur me angazhimin dhe profesionalizmin e tyre, për autoritetet publike, partnerët institucionalë dhe ndërkombëtarë si dhe sektorin privat për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm.

Një falënderim i veçantë i drejtohet edhe subjekteve raportuese për profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre, si një hallkë thelbësore në forcimin e sistemit parandalues.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, ju ftoj të njiheni me këtë raport dhe së bashku të vazhdojmë drejt qëllimit të përbashkët për një sistem financiar të sigurt, transparent dhe të qëndrueshëm.


MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR DHE URDHRAT E BLOKIMIT TË PËRKOHSHËM

Aktiviteti kryesor i AIF, në cilësinë e Njesisë së Inteligjencës Financiare, lidhet me analizimin e informacionit të raportuar përmes RAD nga subjektet e ligjit, i cili plotësohet, kur është e nevojshme, me të dhëna shtesë për të mbështetur konkluzionet tona. Ky proces ka rëndësi themelore për funksionimin e institucionit, pasi mbi bazën e tij krijohen kushtet për nisjen e verifikimeve dhe investigimeve, referimin e informacionit pranë organeve kompetente, identifikimin dhe përditësimin e tipologjive të PP/FT, vlerësimin e rreziqeve, orientimin e subjekteve të ligjit për përmirësimin e sistemit parandalues, si dhe rritjen e efikasitetit në parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjatë vitit 2025, në AIF janë dërguar 1,759 RAD nga subjektet raportuese, të cilat paraqiten të kategorizuara në tabelën 1, të krahasuara me periudhat pararendëse.

Tabelë 1: RAD të raportuara, sipas kategorisë së subjekteve për periudhën 2021 – 2025.

Subjekti raportues	2021	2022	2023	2024	2025
Banka	725	660	756	718	750
Shoqëri transfertash	290	293	323	365	331
DPD	33	25	24	8	12
DPT	6	9	8	4	25
ASHK	16	22	29	33	8
Noter	482	735	516	413	486
ZKV	4	9	32	19	75
Inst. financiare të mikro-kredisë	17	28	21	16	26
Shoqëri të qiradhënies financiare	1	0	5	6	6
Shoqëri ndërtimi	2	0	1	0	0
Shoqëri tregtimi mjeteve motorike	0	3	3	8	3
Shoqëri pagesash elektronike	0	1	1	26	25
Avokat	1	0	0	0	0
Ndërmjetës të Pasurive të Paluajtshme	0	0	1	5	5
Shoqëri transporti	0	0	0	0	0
Fond investimi	0	0	1	0	3
Shoqëri pagesash/Posta Shqiptare	3	5	7	9	1
Lojra Fati	0	0	0	2	2
Tjetër	1	0	0	0	1
Total	1,581	1,790	1,728	1,632	1,759

Grafik 1: Ecuria e raportimeve të RAD për periudhën 2021 - 2025



Bazuar në të dhënat e tabelës nr.1, rezulton se këtë vit mbizotërojnë në numër raportimet nga subjektet banka, noter dhe subjektet që ushtrojnë aktivitet si shoqëri transfertash. Numri i RAD në vitin 2025 ka një rritje me rreth 8%, krahasuar me vitin 2024. Krahasuar me vitin 2024, i marrë si pikë referuese, evidentohet një rritje e numrit të RAD të ardhura nga bankat (4.5%), noterët (17.7%), ZKV (pothuajse trefishim), DPT (pothuajse pesëfishim) dhe subjektet e mikrokredisë (62%). Ndërkohë, konstatohet një rënie e RAD-ve nga shoqëritë e transfertave (9.3%), të cilat megjithatë mbeten ende ndër dërguesit me peshë të konsiderueshme të RAD.

Tabelë 2: Rastet e dërguara në organet ligjzbatuese për periudhën 2021-2025*.

Viti	2021	2022	2023	2024	2025
Prokurori të Rretheve	21	13	19	31	24
SPAK	29	10	26	36	32
Polici	208	201	174	167	133
DPT	24	19	19	25	80
Total	282	243	238	259	269

* Në statistikën e përpunuar të vitit 2025, është vlerësuar të përfshihen edhe informacionet e dërguara në DPT . Ky element është përfshirë edhe në vitet e tjera.

Analizimi përbën një proces kompleks dhe dinamik, i mbështetur në një sërë komponentësh, si: indikatorët e identifikuar, informacioni paraprak dhe i siguruar, si dhe kryqëzimi i të dhënave nga burime të ndryshme, me qëllim evidentimin dhe dokumentimin e rasteve të dyshimta që mund të lidhen me pastrimin e parave, vepra penale apo veprimtari kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, financimin e terrorizmit, si edhe financimin e armëve të shkatërrimit në masë. Rezultatet e këtij procesi shërbejnë për dërgimin e rasteve për investigim pranë agjencive të zbatimit të ligjit, organeve të inteligjencës, ose NJIF partnere, sipas juridiksionit dhe natyrës së çështjes. Një nga funksionet më të rëndësishme të AIF është mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e informacionit mbi rastet e dyshimta tek organet kompetente, në veçanti pranë DPPSH, Prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm si dhe SPAK. Në këtë kontekst, duhet theksuar se DPPSH, si organi kompetent në vend dhe i specializuar në kryerjen e veprimeve hetimore, mbetet institucioni kryesor, për rastet e dërguara nga AIF. Krahas dërgimit të rasteve në Prokurori dhe Polici, gjatë vitit 2025 AIF ka dërguar edhe 80 raste pranë DPT, të konkluduara me dyshime për evazion fiskal, fshehje të ardhurash, shkelje të tjera të legjislacionit tatimor, si edhe raste të tjera ku është vlerësuar se DPT disponon ekspertizën dhe kompetencat më të përshtatshme për trajtimin e tyre. Gjithashtu, në vitin 2025, AIF ka dërguar 57 informacione në SHISH, lidhur me çështje të dyshuara për veprimtari kriminale, si objekt i përbashkët interesi dhe bashkëpunimi ndër-institucional. Përveç dërgimit të rasteve të reja, një rëndësi të veçantë për AIF kanë edhe informacionet vijuese, përmes të cilave u transmetohen organeve kompetente, të dhëna shtesë dhe të përditësuara, të lidhura me informacionet e dërguara më parë nga vetë AIF, si edhe me kërkesat specifike të këtyre organeve në vijim të verifikimeve dhe hetimeve të tyre. Për sa i përket indicieve fillestare për rastet e referuara nga AIF pranë agjencive ligjzbatuese, rezulton se burimi kryesor mbeten RAD e paraqitura nga subjektet e ligjit, të cilat kanë shërbyer si pikënisje për rreth 83% të rasteve. Pjesa e mbetur, përbëhet nga raste të iniciuara mbi bazën e analizave strategjike dhe sektoriale që AIF realizon, si dhe burime të tjera.

Tabelë 3: Indiciet për rastet e dërguara gjatë vitit 2025 në DPPSH, Prokurori dhe DPT

Indiciet	RAD	NjIF Partnere	Analiza Strategjike	Burime të hapura	Kërkesa nga institucione	Total
Raste të dërguara në Prokurori	51	0	3	1	1	56
Raste të dërguara në Polici	95	1	34	1	2	133
Raste të dërguara në DPT	79	0	1	0	0	80
Total	225	1	38	2	3	269

*Në statistikën e përpunuar të vitit 2025, është vlerësuar të përfshihen edhe informacionet e dërguara në DPT.

Gjenerimi i rasteve me indicie fillestare nga RAD-të është një tregues i funksionimit të sistemit parandalues dhe i përmirësimit të tij të vazhdueshëm. RAD shërbejnë si pikënisje për një proces analize, i cili, në varësi të rastit, pasurohet me të dhëna shtesë të siguruara nga subjektet e ligjit (p.sh. banka, noterë etj.), nga NJIF homologe, si edhe nga autoritete të tjera me të cilat AIF bashkëpunon.

Të gjitha këto të dhëna analizohen dhe vlerësohen në mënyrë të integruar, me qëllim konkludimin nëse ekzistojnë ose jo dyshime të arsyeshme që mund të lidhen me pastrimin e parave, vepra penale apo veprimtari kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, si edhe me financimin e terrorizmit.

AIF i kushton rëndësi të veçantë edhe identifikimit të mënyrës së veprimit dhe metodave të përdorura në pastrimin e produkteve të veprës penale, si edhe financimin e terrorizmit.

Gjatë vitit 2025, në terma të përgjithshëm dhe për qëllime përmbledhëse, janë evidentuar treguesit e mëposhtëm të aktivitetit të dyshimtë:

- Investime në pasuri të paluajtshme në vlera të larta, me burim fondesh të paqartë, të panjohur ose të pajustificuar.
- Përdorimi i personave të tretë për kryerjen e transaksioneve dhe investimeve, pa lidhje të dukshme me palët ose me aktivitetin, në funksion të fshehjes së origjinës së të ardhurave.
- Dhurime dhe hua (nga/ndaj të tretëve) pa marrëdhënie të qarta që justifikojnë transaksionet ndërmjet palëve, si edhe transaksione me dyshime mbi burimin e fondeve dhe gjetje negative për palët e përfshira.
- Veprime financiare të lidhura me dyshime për evazion fiskal ose fshehje të ardhurash.
- Transaksione të kryera nga persona të dyshuar për përfshirje në veprimtari kriminale të mëparshme, ose me lidhje me persona me precedentë penalë.
- Transferta të dyshimta (në hyrje, në dalje, si edhe në tentativë), me përfshirje subjektesh dhe shtetasish të huaj, të pajustificuara me dokumentacion mbështetës.
- Depozitime në para fizike, me burim fondesh të panjohur ose të pajustificuar.
- Transaksione me dyshime për mashtrime të mundshme, përfshirë mashtrime financiare dhe kompjuterike.
- Shitblerje kuotash/aksionesh të personave juridikë me çmime ndjeshëm më të ulëta ose më të larta se vlera e kapitalit neto të shoqërisë.
- Rritje të dyshimta të kapitalit të personave juridikë, me burim të panjohur të ardhurash dhe/ose me elementë fiktiviteti.
- Transferta të konsiderueshme vlerash (brenda dhe jashtë vendit) ndërmjet personave juridikë, të pambështetura me dokumentacion të besueshëm për mallrat ose shërbimet e shkëmbyera.
- Transferta të dyshimta me vende të konsideruara me risk, të pambështetura ose të pajustificuara me dokumentacionin e duhur.
- Transaksione me dyshime/anomali të kryera nga PEP, ish-PEP, familjarë ose lidhje të tyre biznesi.
- Blerje pasurish të paluajtshme nën vlerën e tregut.
- Përfshirja e personave të njëjtë ose të lidhur në biznese të shumëfishta, me qëllim qarkullimin e fondeve, fshehjen e origjinës dhe destinacionit të tyre, përmes zinxhirit të transaksioneve në disa vende.

Bazuar në rastet e dërguara nga AIF në organet ligjzbatuese gjatë vitit 2025 është hartuar një numër i lartë tipologjish të rasteve të dyshuara për pastrim parash (të pasqyruara në Shtojcën 1 të raportit), me qëllim informimin e subjekteve raportuese si dhe publikut të gjerë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Gjatë analizës së rasteve të dërguara nga AIF në agjencitë ligjzbatuese, kur është e mundur apo ka të dhëna, identifikohet vepra penale origjinuese e dyshuar apo lidhje të mundshme kriminale të personave dhe subjekteve.

Tabelë 4: Të dhëna për klasifikimin e veprës së origjinës, për periudhën 2021 – 2025*.

Veprat e origjinës	2021	2022	2023	2024	2025
Prodhim/Shitje/Trafikim të lëndëve narkotike	39	44	47	45	41
Trafikim i qenieve njerëzore/shfrytëzim prostitucioni	3	6	1	2	4
Veprime financiare nga organizata kriminale	11	6	10	7	9
Veprime nga persona të dyshuar si të përfshirë në terrorizëm, FT, ekstremizëm	3	7	5	4	2
Mashtrim, mashtrim financiar, mashtrim kompjuterike	21	16	20	15	12
Falsifikim	3	5	4	3	3
Shpërdorim detyre/Korrupsion/Dyshim për ushtrimi të ndikimit të paligjshëm	21	7	13	17	6
Mosdeklarim shumave dhe sendeve me vlerë në kufi	0	0	0	1	2
Vjedhje, grabitje, kanosje	1	4	7	4	5
Trafikim i mjeteve motorike/shmangie detyrime doganore/kontrabandë	0	2	0	0	1
Vepra penale në fushën e tatim taksave Dyshime për evazion fiskal/(fshehje të ardhurash)	28	23	25	31	85
Precedentë të mëparshëm kriminalë/procedim të mëparshëm	7	20	16	28	10
Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit ose emigracion i paligjshëm	0	8	3	11	3
Vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare	0	0	0	2	2
Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit	0	0	0	1	1
Nuk dihet	145	95	87	88	83
Total	282	243	238	259	269

* Në statistikën e përpunuar të vitit 2025, është vlerësuar të përfshihen edhe informacionet e dërguara në DPT. Ky element është përfshirë edhe në vitet e tjera.

Tabela e mësipërme, paraqet rastet e dërguar në organet ligjzbatuese Prokurori, DPPSH dhe DPT, për të cilat është arritur të përcaktohet vepra penale kryesore e origjinës.

Për vitin 2025, numrin më të lartë të veprimtarive kriminale, për të cilat është bërë i mundur identifikimi i lidhjes me veprën e origjinës e zënë krimet në fushën narkotike, vepra penale në fushën e tatim taksave/dyshime për evazion fiskal, mashtrimi, rastet kur personat kanë pasur precedentë të mëparshëm kriminalë apo procedim të mëparshëm.

Ngjashëm me vitet e mëparshme, për një numër të konsiderueshëm rastesh nuk ka qenë e mundur të përcaktohet vepra penale origjinuese. Megjithatë, nga analiza financiare është arritur në përfundimin se:

- Veprimet financiare paraqisnin anomali dhe/ose dyshime të dukshme;
- Fondet e përdorura nuk rezultojnë me burim të ligjshëm, nuk ishin të mbështetura me dokumentacion shoqëruar, apo mungonin të dhëna të tjera të besueshme për justifikimin e tyre;
- Qëllimi ekonomik-ligjor i transaksioneve ishte i paqartë ose i dyshimtë;
- Transaksionet paraqisnin ngjashmëri me tipologji të njohura të pastrimit të parave, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Në zbatim të parimit “ndiq paranë”, si një nga parimet themelore të punës së NJIF, këto raste dërgohen për ndjekje të mëtejshme pranë agjencive ligjzbatuese, me qëllim verifikimin e plotë të rrethanave dhe identifikimin e elementëve që mund të tregojnë veprimtari kriminale dhe/ose veprën penale të origjinës.

Urdhrat e bllokimit të përkohshëm

Në rastet kur AIF ka arsye të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete për PP/FT, në funksion të parandalimit të tjetërsimit të produkteve financiare kriminale, urdhëron bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit ose të veprimit financiar, për një periudhë jo më shumë se 72 orë dhe informon prokurorinë kompetente dhe sipas rastit organe të tjera të zbatimit të ligjit. Gjatë vitit 2025, janë nxjerrë në total 8 urdhra bllokimi të përkohshëm për llogari bankare, në një vlerë totale prej rreth 793,375 EUR, të cilat janë sekuestruar me vendim të Prokurorisë apo Gjykatës në masën 96%.

Tabelë 5: Urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimet (në EUR) për periudhën 2021 - 2025.

Viti	Nr. i urdhrave të bllokimit nga AIF	Pasuria totale e bllokuar (EUR)	Pasuria totale e sekuestruar (EUR)	Raporti sekuestrime/bllokime
2021	3	250,240	200,000	80%
2022	3	2,426,882	2,426,882	100%
2023	4	1,178,350	1,100,350	93%
2024	11	10,751,684	10,418,238	97%
2025	8	793,375	763,375	96%

**MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E
INFORMACIONIT FINANCIAR DHE URDHRAT E
BLOKIMIT TË PËRKOHSHËM**

NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE DHE ANALIZA E PËRPUTHSHMËRISË

Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese

Subjektet e ligjit nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar, kanë një rol parësor për të parandaluar depozitimin, përdorimin dhe transferimin e fondeve të jashtëligjshme në sistemin ekonomiko-financiar të vendit dhe si të tilla përbëjnë vijën e parë të mbrojtjes.

Në vitin 2025, AIF ka vijuar në mënyrë të vazhdueshme punën për përmirësimin e nivelit të përputhshmërisë së subjekteve, në përputhje me kuadrin ligjor në fushën e PPP/FT/ADM.

Trajnimi i subjekteve të ligjit për çështjet e PPP/FT/ADM, mbetet një nga detyrat funksionale të AIF.

Në këtë kontekst në vitin 2025, janë organizuar një sërë trajnimesh për disa kategori subjektesh (Banka, IFJB, ZKV, shoqëri transfertash dhe agjentët e tyre, fonde investimi dhe pensione private, auditues ligjor, tregëtar të metaleve dhe gurëve të çmuar, noterë, kontabilistë të miratuar, kazino dhe ndërmjetës të pasurive të paluajtshme) në të cilët kanë marrë pjesë 1,080 persona, që përbën një rritje prej 18% krahasuar me vitin 2024 (917 pjesëmarrës).

Trajnimet e AIF, organizohen në bazë të planit të integruar të trajnimeve të miratuar nga GTNP për vitin 2025, kërkesave për trajnim të paraqitura nga shoqatat apo vetë subjektet raportuese si dhe bazuar në mangësitë e evidentuara në kuadër të inspektimeve që realizohen nga institucioni.

Aktivitetet trajnuese janë zhvilluar gjithashtu edhe në kuadër të bashkëpunimit me shoqatat që përfaqësojnë kategori të ndryshme të subjekteve raportuese.

Theksi gjatë këtij viti është vënë në organizimin e trajnimeve për noterët (në bashkëpunim me DHKN), ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme (në bashkëpunim me NAREA) dhe kontabilistët e miratuar (në bashkëpunim me Shoqatën e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë dhe Institutin e Kontabilistëve të Miratuar).

Nëpërmjet bashkëpunimit me shoqatat dhe autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese, AIF ka synuar të prezantojë përvojën në fushën e PPP/FT/ADM si dhe të vlerësohet niveli i përputhshmërisë së subjekteve me legjislacionin në fuqi.

Procesi i trajnimeve, është realizuar sipas planit vjetor të AIF për 2025, në të cilin janë identifikuar aspektet kryesore duke vënë në mënyrë të veçantë theksin tek zbatimi efektiv i masave PPP/FT/ADM, vigjilenca e duhur dhe e zgjeruar ndaj klientit, vlerësimin individual të riskut PP/FT nga subjektet dhe kategorizimin e klientëve të tyre mbi bazën e këtij vlerësimi, monitorimi i marrëdhënies së biznesit me PEP, ndryshimet në legjislacionin e PPP/FT, analizimin dhe raportimin e transaksioneve komplekse, tipologjitë dhe treguesit e PP/FT, identifikimin dhe verifikimin e pronarit përfitues të personave juridik, zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare për personat e shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, adresimin e rekomandimeve të FATF, të Komitetit Moneyval dhe institucioneve të tjera monitoruese, etj.

AIF ka synuar që efekti i aktiviteteve të trajnimit të zhvilluara në vitin 2025, të shtrihet te të gjithë kategoritë e subjekteve raportuese, duke vënë theksin veçanërisht në ato subjekte që kategorizohen me risk të mesëm dhe të lartë për PP/FT.

Në tabelën vijuese, paraqiten të dhënat periodike, në lidhje me numrin e personave të trajnuar sipas subjekteve të ligjit.

Tabelë 6: Numri i personave të trajnuar për periudhën 2021 - 2025, sipas kategorive të subjekteve.

Subjekti	2021	2022	2023	2024	2025
Banka	4	20	-	30	30
ZKV dhe agjentë të transferimit të parave	42	15	332	219	25
Shoqëri Transfertash	-	-	-	-	4
IFJB	24	26	18	6	11
Lojëra Fati	1	2	3	-	10
Noterë/avokat	199	63	30	4	395
Auditues Ligjor	26	9	1	255	2
Shoqëri Sigurimi jete, broker	1	11	1	10	
Autoritete Mbikëqyrëse dhe Institucione	5	4	-	-	23
Shoqëri tregtimi të automjeteve	-	2	-	1	1
OJF	2	1	-	-	
Shoqëri ndërtimi	18	12	9	-	2
Shoqëri të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të fondeve të pensionit	-	1	2	17	1
Agjentë të pasurive të paluajtshme	6	23	20	70	66
Agjensi udhëtimi	1	2	-	-	3
SHKK	1	7	-	-	
Kontabël i miratuar	540	153	256	305	506
Përmbaues privat	-	-	5	-	
Metale dhe gurë të çmuar	-	-	-	-	1
Totali	870	362	677	917	1,080

Inspektimet në vend apo në distancë të subjekteve nga ana e AIF, kanë gjithashtu një rol të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve të tyre PPP/FT/ADM.

Këto inspektime krahas kontrollit për zbatimin e detyrimeve ligjore, ofrojnë dhe ndihmesën përkatëse në drejtim të zbatimit të në vijimësi të detyrimeve ligjore, duke e shoqëruar dhe me rastet praktike të punës së tyre.

Procesi i trajnimit dhe komunikimit, luan një rol vendimtar në nxitjen e ndërgjegjësisimit dhe të kuptuarit nga subjektet, të legjislacionit të PPP/FT/ADM, nëpërmjet angazhimit, dialogut dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm.

Ky funksion ofron udhëzime për subjektet, duke siguruar qartësi në interpretim dhe zbatim të detyrimeve të tyre PPP/FT, të bazuara në rrezik. Këto aktivitete nxisin kulturën e përputhshmërisë, duke i pajisur subjektet me njohuritë dhe ekspertizën e kërkuar, për të zbatuar në mënyrë efektive masat PPP/FT/ADM.

Analizimi i përputhshmërisë, inspektimet në vend dhe në distancë

AIF ushtron procesi e mbikëqyrjes së subjekteve raportuese, bazuar në germën ‘ç’ të Nenit 22 “Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës”, të ligjit nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar. Në këtë kontekst, përputhshmëria e subjekteve raportuese me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për PPP/FT/ADM, përbën një ndër objektivat kryesorë të veprimtarisë së AIF në fushën e mbikëqyrjes. Për të siguruar efektivitetin e procesit të mbikëqyrjes së përputhshmërisë, puna e AIF në vitin 2025 është orientuar në ato kategori subjektsh, të cilat kategorizohen me nivel të lartë apo të mesëm të riskut PP/FT.

Në këtë kuadër, AIF i ka kushtuar një vëmendje të vazhdueshme përdorimit efektiv të burimeve njerëzore dhe teknike, me qëllim që të sigurojë një ndikim sa më të gjerë në nivelin e përputhshmërisë së subjekteve, duke realizuar krahas procesi të inspektimit dhe trajnimit e subjekteve raportuese. Koordinimi dhe bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese, ka qenë një nga komponentet kryesor të aktivitetit të AIF në 2025.

Në këtë kontekst, në bashkëpunim me BSH¹ dhe AMLF² janë realizuar inspektime të përbashkëta në subjektet e ligjit. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për inspektimet në vend dhe në distancë të vitit 2025, të krahasuara me periudhat pararendëse.

Tabelë 7: Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2021 – 2025.


Nr.	Subjektet	2021		2022		2023		2024		2025	
		Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë	Vend	Distancë
1	Banka	5		3		4		3		4	
2	IFJB	7	5	1	1	6	1	7	3	5	
3	ZKV	4	20	7	10	4	16	2	2	8	11
4	Ekspertë kontabël				5	2	10	3	2		3
5	Shoqëri ndërtimi	9	14	7	5	2	3	1	5	3	18
6	Mjete motorike					2	1	1	2		
7	Noterë	7	31	8	14	2	3	2	18	3	21
8	Lojëra Fati			1		5	1			6	
9	Sigurim jete dhe risigurim	1		3				2			
10	Studio Ligjore	9	19	6				2		2	4
11	Shoqëri të kursim kreditit			1	8			1			
12	Metale të çmuara			1							3
13	Agjensi të pasurive të paluejtshme			2	3	2	7	2	8	5	8
14	Fonde Investimi/ Pensioni/Depozitarë			2				2	1		
15	Agjenci Udhëtimi		1				1		1	2	1
16	Përmbarues Gjyqësor Privat			2	18		1				
	Shuma	42	90	44	64	29	44	28	42	38	69
	TOTALI	132		108		73		70		107	

1 Dy (2) inspektime në subjekte Bankë dhe ZKV.

2 Gjashtë (6) inspektime në subjekte kazino.

Për vitin 2025, janë planifikuar 40 inspektime në vënd, prej të cilave janë realizuar 38, ndërsa inspektimet në distancë nga 73 të planifikuara janë realizuar 69. Numri total i inspektimeve në vitin 2025, ka shënuar një rritje prej 53%, krahasuar me vitin 2024. Procesi i mbikëqyrjes së AIF është përqendruar në inspektimet e subjekteve me risk të lartë³ (Banka 4 inspektime, shoqëri ndërtimi 21 inspektime, Noterë 24 inspektime) në total 49, që përbëjnë 46% të inspektimeve, ndërkohë që pjesa e mbetur përfshijnë subjekte me risk të mesëm 46% dhe me risk të ulët 8%.

Grafik 2: Paraqitje grafike për nivelin e riskut për subjektet e inspektuara gjatë 2025:



Bazuar në rezultatet e inspektimeve, vërehet se subjektet janë përgjithësisht të angazhuara në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Megjithatë, nga 107 inspektime të realizuara, në 67 raste (63%) janë identifikuar shkelje administrative, për të cilat janë vendosur 27 masa administrative “Gjobë” dhe 37 masa “Paralajmërim”.

MASAT ADMINISTRATIVE DHE PROCESET GJYQËSORE

Masat administrative

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2025 janë evidentuar subjekte që nuk përmbushin nivelin e duhur të përputhshmërisë me kuadrin rregullator për PPP/FT, për të cilët ka vijuar procesi i shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, deri në dhënien e vendimit të arsyetuar me masë administrative “gjobë” apo “paralajmërim”, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore. Përveç inspektimeve në vend, janë vlerësuar edhe praktika të mbikëqyrjes në distancë nëpërmjet Raporteve të Kontrollit në Distancë apo indicie nga monitorimi në distancë i subjekteve të ligjit për shkelje të detyrimeve ligjore, të cilat zënë edhe peshën kryesore, krahasuar me inspektimet në vend. Gjatë kësaj periudhe të vitit janë marrë në shqyrtim nga Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative gjithsej 67 subjekte, të ndara sipas kategorive si më poshtë evidentuar.

Tabelë 8: Kundërvajtjet administrative të shqyrtuara sipas kategorive të subjekteve

Subjektet	Nr. shqyrtimeve
Noter	17
ZKV	15
Shoqëri auditimi	1
Shoqëri udhëtimi	3
Ndërmjetësuese Pasurish	6
IFJB	6
Shoqëri ndërtimi	11
Shoqëri tregtimi mjete motorike	3
Shoqëri sigurimi jete	1
Shoqëri tregtimi metaleve e gurëve të çmuara	2
Lojra fati	2
TOTAL	67

Në përfundim të shqyrtimit të procedurave administrative AIF ka konkluduar me dhënien e masës administrative “Gjobë” për 27 subjekte, masë administrative “Paralajmërim” për 37 subjekte dhe 3 subjekte pushim të procedimit të kundërvajtjes administrative.

Tabelë 9: Masat administrative të dhëna sipas kategorisë të subjekteve

Subjektet	Masa administrative “Gjobë”	Masa administrative “Paralajmërim”	Vendim Pushimi	Nr. i shqyrtime sipas subjekteve
Noter	4	12	1	17
ZKV	8	7	-	15
Shoqëri auditimi	1	-	-	1
Shoqëri udhëtimi	2	1	-	3
Ndërmjetës i Pasurive	1	4	1	6
IFJB	3	3	-	6
Shoqëri ndërtimi	5	6	-	11
Shoqëri tregtimi mjete motorike	1	2	-	3
Shoqëri sigurimi jetë	1	-	-	1
Shoqëri tregtimi i metaleve dhe gurëve	1	1		2
Lojra fati	-	1	1	2
TOTAL	27	37	3	67

Minimumi i gjobës së aplikuar për vitin 2025 ka qenë 100,000 lekë dhe maksimumi 800,000 lekë. Vlera totale e gjobave të vendosura është 8,700,000 lekë. Sipas kategorisë të subjekteve janë dhënë masat administrative (gjoba) si më poshtë:

Tabelë 10: Vlera e masave administrative sipas subjekteve

Subjektet	Nr. i subjekteve	Vlera e masave administrative në Lekë
Noter	4	1,600,000
ZKV	8	2,900,000
Shoqëri Auditimi	1	200,000
Ndërmjetës i Pasurive	1	400,000
IFJB	3	900,000
Shoqëri ndërtimi	5	1,400,000
Shoqëri udhëtimi	2	600,000
Shoqëri tregtimi mjete motorike	1	200,000
Shoqëri sigurimi jete	1	400,000
Shoqëri tregtimi metaleve dhe gurëve të çmuar	1	100,000
TOTAL	27	8,700,000

Tipologjia e kundërvajtjeve administrative të konstatuara për subjektet e ligjit konsiston kryesisht në shkelje të kategorizuara në grupime si më poshtë:

- Moszbatim të detyrimeve që burojnë nga neni 4/1, mbi marrjen e masave në kuadër të vigjilencës së duhur të ligjit;
- Moszbatim të detyrimeve që burojnë nga neni 5, mbi mbajtjen e dokumentacionit për identifikimin e klientit;
- Moszbatim të detyrimit për kryerjen e vigjilencës së duhur dhe/ose të zgjeruar nëpërmjet mbajtjes të analizave, sipas nenit 8, pika 7 e ligjit;
- Moszbatim të detyrimeve që burojnë nga neni 11, pika 1/c të ligjit, në lidhje me mbajtjen sipas kërkesave ligjore të regjistrit të centralizuar;
- Mos raportim të transaksioneve në para fizike mbi pragun e përcaktuar ligjor sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 12 të ligjit.

Në tabelën vijuese paraqiten të dhënat krahasuese për 5 vjeçarën e fundit, për masat administrative të vendosura sipas kategorisë të subjekteve në mbikëqyrje:

Tabelë 11: Të dhëna krahasimore të masave administrative “gjobë” për periudhën 2021-2025.

Subjekte	2021		2022		2023		2024		2025	
	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera
Banka	-	-	-	-	1	1,000,000	-	-	-	-
IFJB	1	300,000	1	1,000,000	-	-	-	-	3	900,000
ZKV	4	1,100,000	3	700,000	11	5,600,000	2	1,000,000	8	2,900,000
Noter	12	3,000,000	3	1,300,000	2	900,000	4	1,300,000	4	1,600,000
Lojëra Fati	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shoqëri Ndërtimi	6	3,800,000	3	1,200,000	-	-	3	900,000	5	1,400,000
Shoq. tregimit të mjeteve motorike	-	-	-	-	-	-	-	-	1	200,000
SHKK	-	-	-	-	1	1,000,000	1	1,000,000	-	-
Ndërmjetës i pasurive të paluajtshme	-	-	-	-	-	-	2	400,000	1	400,000
Auditues ligjor	-	-	-	-	-	-	-	-	1	200,000
Agjenci udhëtimi	-	-	-	-	-	-	-	-	2	600,000
Shoqëri tregtimi i gurëve të çmuar	-	-	-	-	-	-	-	-	1	100,000
Shoqëri sigurimi jete	-	-	-	-	-	-	-	-	1	400,000
TOTALI	23	8,200,000	10	4,200,000	15	8,500,000	12	4,600,000	27	8,700,000

Ekzekutimi i Masave Administrative

Gjatë vitit 2025, nga 27 masa administrative “gjobë” të vendosura, 20 prej tyre janë arkëtuar shumat pas vendimmarrjes të AIF dhe për një (1) subjekt është lidhur marrëveshje për pagesë me këste.

Në total shuma e arkëtuar për masat administrative që i përkasin vitit 2025 është 7,000,000 lekë.

Gjatë vitit 2025 janë arkëtuar edhe masat administrative të debitorëve në vite, sipas të dhënave të paraqitur në tabelën e mëposhtme. Shuma totale e arkëtuar gjatë këtij viti arrin në vlerën prej 18,285,956 lekë.

Tabelë 12: Të dhënat krahasuese të arkëtimeve për periudhën 2021 – 2025

Zërat	2021	2022	2023	2024	2025
Vendime me Gjoba	23	10	14	15	27
Shuma totale e gjobave Lek	8,200,000	4,200,000	7,900,000	8,500,000	8,700,000
Shuma totale e arkëtimit Lek	5,837,638	6,162,005	4,800,000	6,042,400	18,285,956

Për të rritur efikasitetin e ekzekutimit të masave administrative, AIF ka ndjekur me vëmendje fazat e ekzekutimit me zyrat përmbartimore, duke rritur në këtë mënyrë edhe efikasitetin e kësaj veprimtarie, deri në përmbushjen e fazave të ekzekutimit të detyrueshëm duke kaluar në procedurë ekzekutuese dhe bashkëpunuar ngushtësisht me Zyrat e Përmbartimit Shtetëror.

Proceset gjyqësore


AIF i ka kushtuar vëmendje të veçantë ndjekjes së proceseve gjyqësore në lidhje me masat administrative të vendosura gjatë vitit 2025 si dhe çështjeve gjyqësore të mbartura nga vitet e mëparshme. Janë gjithsej 17 (shtatëmbëdhjetë) procese gjyqësore për të cilat Gjykata Administrative e Shkallës së Parë është shprehur me vendim, nga të cilat:

- Për 13 (trembëdhjetë) procese gjyqësore, Gjykata ka dhënë vendimin në favor të AIF;
- Për 2 (dy) procese gjyqësore, Gjykata ka pranuar pjesërisht kërkesë padinë e paditësve;
- Për 2 (dy) procese gjyqësore, Gjykata ka dhënë vendim në favor të paditësit.

Në Gjykatën Administrative të Apelit gjatë vitit 2025 janë shpallur vendimet për 2 (dy) procese gjyqësore për të cilat Gjykata ka vendosur në favor të AIF.

Koordinatori i të drejtës për informim

Gjatë vitit 2025, janë administruar dhe është kthyer përgjigje sipas të drejtës për informim për 15 kërkesa, nga të cilat 3 janë adresuar nga gazetarë të mediave vizive apo të shkruara dhe 12 prej tyre janë kërkesa të adresuara nga publiku. Për të 15 kërkesat AIF ka kthyer përgjigje brenda afateve ligjore dhe pa pagesë.



BASHKËPUNIMI KOMBËTAR

Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës

GTNP i ngritur në zbatim të Vendimit nr. 1 të KBLKPP të datës 27 Dhjetor 2023, ka vijuar edhe gjatë vitit 2025 ushtrimin e funksioneve dhe aktiviteteve në përmbushje prioriteteve të përcaktuara si më poshtë:

- Përgatitja për raundin e 6-të të vlerësimit nga Komiteti Moneyval;
- Vijimi i zbatimit të Planit të Veprimit të “Strategjisë Kombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024–2030”;
- Vijimi i zbatimit të Planit të Veprimit të “Vlerësimit Kombëtar të Riskut” (NRA);
- Koordinimi dhe angazhimi në zbatimin e “Strategjisë për edukimin e publikut mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në shoqërinë tonë 2025–2027”;
- Zbatimi i Planit të integruar të trajnimeve për vitin 2025;
- Ndjekja e takimeve të nëngrupeve të GTNP.

Gjatë vitit 2025 në GTNP janë anëtarësuar edhe tre institucione të reja: Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE), Shoqata Mikrofinanca Shqiptare (SHMSH) dhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (DHTIT), duke rritur numrin e anëtarëve të GTNP në 38 anëtarë.

Përmbledhje e aktiviteteve të GTNP për vitin 2025

GTNP gjatë vitit 2025, ka zhvilluar një sërë aktiviteteve të rëndësishme, në mbështetje të përmbushjes së prioriteteve të përcaktuara si dhe duke luajtur një rol të rëndësishëm në koordinimin ndërinstitucional, shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin midis institucioneve publike dhe përfaqësuesve të sektorit privat në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. GTNP ka zhvilluar një sërë takimesh gjatë vitit 2025, të cilat pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në vijim:



Trajnimi për raundin e 6-të të vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL (11–12 mars 2025)

Në datat 11–12 mars 2025 u zhvillua një trajnim dyditor nga dy përfaqësues të Sekretariatit të Komitetit MONEYVAL, në kuadër të raundit të 6-të të vlerësimit të Shqipërisë.

Në këtë trajnim morën pjesë rreth 120 pjesëmarrës, anëtarë të GTNP, përfaqësues të institucioneve publike, përfshirë institucionet ligj zbatuese dhe ato mbikëqyrëse, si dhe përfaqësues të sektorit privat.

Gjatë ditës së parë, pjesëmarrësit ndoqën prezantimet e trajnerëve mbi procedurat dhe afatet e vlerësimit të raundit të 6-të, si dhe ndryshimet kryesore të standardeve dhe metodologjisë së FATF (standartet kundër pastrimit të parave që shërbejnë si bazë për vlerësimin e shteteve në nivel global).

Gjithashtu, përfaqësues të sektorit publik, si Agjencia e Inteligjencës Financiare, Qendra Kombëtare e Biznesit, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, paraqitën prezantime mbi sektorët përkatës, përfshirë vlerësimin e riskut, transparencën e të dhënave të pronarëve përfitues, mbikëqyrjen e institucioneve financiare dhe ofruesve të shërbimeve të mjeteve virtuale.

Në përfundim të sesioneve, u dhanë komente dhe sugjerime të vlefshme për raportimin e mëtejshëm gjatë procesit të vlerësimit, si dhe për ndërhyrjet e nevojshme përmirësuese në sistemin parandalues.

Në ditën e dytë të trajnimit, u zhvilluan intervista simuluese nga përfaqësuesit e Sekretariatit me autoritetet shqiptare, në lidhje me procedimet penale për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale, mbikëqyrjen dhe kontrollin e lidhjeve të mundshme kriminale të profesioneve të lira jo financiare (DNFBP), si dhe mekanizmat dhe mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve financiare për personat dhe entitetet e shpallura.

Mbledhja e GTNP – Datë 4 Prill 2025

GTNP u mbledh në datë 4 prill 2025 me pjesëmarrjen e anëtarëve të përhershëm, përfaqësues të institucioneve publike dhe sektorit privat. Nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AIF, mbledhja u përqëndrua në trajtimin e këtyre çështjeve:

- Vlerësimin nga Komiteti Moneyval në raundin e 6-të për Shqipërinë, plotësimin e pyetësorëve dhe afatet përkatëse;
- Ushtrimet simuluese për rezultatet imediate IO1, IO4, IO5 dhe IO9;
- Informacion mbi zbatimin e “Strategjisë Kombëtare të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024–2030”, “Vlerësimit Kombëtar të Riskut” dhe “Strategjisë për edukimin e publikut mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në shoqërinë tonë”;
- Diskutimin mbi zbatimin e Planit të Integruar të Trajnimeve;
- Vijueshmërinë e zbatimit të prioritetëve të GTNP për vitin 2025.

Në mbledhje u theksua rëndësia e plotësimit të pyetësorëve në kaudër të raundit të 6-të të vlerësimit në mënyrë të saktë dhe cilësore, respektimin e afateve për plotësimin e tyre, si dhe mbledhjen e statistikave të plota dhe gjithëpërfshirëse.

Mbledhja GTNP – Datë 18 Korrik 2025

GTNP u mbledh në datë 18 korrik 2025 me pjesëmarrjen e anëtarëve të përhershëm, përfaqësues të institucioneve publike dhe sektorit privat. Nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AIF, mbledhja u përqëndrua në trajtimin e këtyre çështjeve:

- Informacion mbi plotësimin e Pyetësorit të Teknikalitetit dhe Pyetësorit të Efektivitetit në kuadër të raundit të 6-të të vlerësimit të Shqipërisë nga MONEYVAL;
- Monitorimin e zbatimit të “Strategjisë Kombëtare të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024–2030” dhe planit të saj të veprimit, periodha janar–prill 2025;

- Monitorimin e zbatimit të “Vlerësimit Kombëtar të Riskut” dhe planit të tij të veprimit, periudha janar–prill 2025;
- Diskutimin mbi zbatimin e Planit të Integruar të Trajnimeve dhe “Strategjisë për edukimin e publikut mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në shoqërinë tonë” dhe planin e saj të veprimit;
- Aktivitetin e nëngrupit të GTNP “Për mbledhjen dhe cilësinë e informacionit për investigimet penale në lidhje me PP/FT”.

Në mbledhje u theksua rëndësia e raundit të 6-të të vlerësimit nga MONEYVAL dhe domosdoshmëria e plotësimit të saktë dhe cilësor të pyetësorëve, si dhe respektimin e afateve për plotësimin e tyre, në mënyrë që të arrihet një rezultat sa më efektiv, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe vijimin e zbatimit të masave dhe strategjive në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimi në masë.

Mbledhja e GTNP - Datë 19 Shtator 2025

GTNP u mbledh në datë 19 Shtator 2025 me pjesëmarrjen e anëtarëve të përhershëm, përfaqësues të institucioneve publike dhe sektorit privat. Nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AIF, mbledhja u përqëndrua në trajtimin e këtyre çështjeve:

- Plotësimin dhe kontributin nga ana e institucioneve për Pyetësin e Teknikalitetit dhe Pyetësin të Efektivitetit të Raundit të 6-të nga Moneyval;
- Prezantimi i zbatimit të planit të veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut (NRA) mbi nevojën për përditësim të masave të këtij plani në raport me rreziqet në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë;
- Monitorimi i zbatimit të “Strategjisë Kombëtare të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024 – 2030” dhe plani i saj i veprimit për periudhën Maj-Gusht 2025;
- Diskutim mbi zbatimin e Planit të Integruar të trajnimeve dhe “Strategjinë për edukimin e publikut mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në shoqërinë tonë” dhe planin e saj të veprimit.

Të gjitha institucionet pjesëmarrëse, publike dhe private, raportuan mbi ecurinë e kontributit të dhënë për plotësimin e pyetësorëve të raundit të 6-të të vlerësimit nga Moneyval.

Nga ana tjetër u theksua nevoja për përgjegjëshmëri dhe përkushtim maksimal nga të gjithë institucionet në respektimin e afateve dhe plotësimin e çdo informacioni në mënyrë të saktë dhe cilësore.

Mbledhja e GTNP – Datë 12 Nëntor 2025

GTNP u mbledh në datë 12 nëntor 2025 me pjesëmarrjen e anëtarëve të përhershëm, përfaqësues të institucioneve publike dhe sektorit privat.

Mbledhja u zhvillua edhe me pjesëmarrjen e veçantë të Z. Philipp Arnold, Zëvendës ambasador i Zvicrës në Shqipëri, i cili gjatë fjalës së tij prezantoi aktivitetet të projektit të ri të mbështetur nga Qeveria Zvicerane (përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike – SECO) dhe Këshillit të Evropës, i cili do të zbatohet në Shqipëri, si dhe mënyrat se si institucionet shqiptare do të përfitojnë nga ky projekt. Nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AIF, mbledhja u përqëndrua në trajtimin e çështjeve që mbulojnë periudhën katër mujorë maj–gusht 2025 në lidhje me:

- Plotësimi i pyetësorit të efektivitetit të raoundit të 6shtë të vlerësimit;
- Zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe planit të veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut (NRA);
- Prezantimin e Planit të Integruar të Trajnimeve dhe zbatimin e “Strategjisë së edukimit të publikut mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe armët e shkatërrimit në masë në shoqërinë tonë”.

Gjatë takimit, të gjitha institucionet pjesëmarrëse diskutuan mbi ecurinë e plotësimit të Pyetësorit të Efektivitetit dhe raportuan progresin e tyre deri në atë moment.

Në mbledhje u ritheksua gjithashtu nevoja për plotësimin e saktë dhe cilësor të pyetësorëve, respektimi i afateve të përcaktuara, si dhe angazhimi i AIF për ofrimin e asistencës për të gjitha institucionet raportuese gjatë procesit të plotësimit të pyetësorëve, në mënyrë që të sigurohet një rezultat i matshëm dhe i suksesshëm.

Mbledhja e GTNP – Datë 22 Dhjetor 2025

GTNP u mbledh në datë 22 dhjetor 2025 me pjesëmarrjen e anëtarëve të përherëshëm, përfaqësues të institucioneve publike dhe sektorit privat. Nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AIF, mbledhja u përqëndrua në trajtimin e këtyre çështjeve:

- Ecuria e procesit të plotësimit të Pyetësorit të Efektivitetit, ku institucionet raportuan mbi progresin dhe nevojën për aistim gjatë këtij procesi;
- Hartimi i Planit të Integruar të Trajnimeve për vitin 2026, ku u diskutuan nevojat për trajnime, temat prioritare dhe koordinimi ndërinstitutional i aktiviteteve trajnuese. Institucionet ranë dakord për vijimin e procedurave për miratimin e këtij plani.



Takimi u fokusua gjithashtu në vijueshmërinë e zbatimit të prioriteteve të GTNP për vitin 2026, duke riafirmuar angazhimin e institucioneve për monitorim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim efektiv ndërinstitutional. Në takim u theksua nevoja për përkushtim maksimal, përgjegje të sakta dhe respektim të afateve, me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit të raportuar.

Zbatimi i Dokumentave Strategjik

Axhenda e Reformave

Agjencia e Inteligjencës Financiare është një nga institucionet zbatuese të Axhendës së Reformave (*Reform and Growth Facility 2024-2027/ Growth Plan for Western Balkans Countries*), dokument që ka një rëndësi të posaçme pasi shërben si matës progresi, ku realizimi i plotë objektivave të përcaktuar ndikon në përshpejtimin e zhvillimit socio-ekonomik të Shqipërisë dhe konsolidon më tej procesin e integritetit të vendit në BE. Axhenda e Reformave përbëhet nga 6 objektiva kryesorë të cilat adresohen nëpërmjet masave konkrete dhe të matshme. Ndër të tjera, nën objektivin 5 “Rule of Law” masa 5.3 janë përfshirë për zbatim dy pika nga AIF: (i) Miratimi i një strategjie për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe (ii) Realizimi në kohë dhe efektiv i masave të Planit të Veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Riskut (NRA).

Në këtë kuadër AIF ndjek në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e dy pikave të masës 5.3.1 nga të cilat pika e parë është zbatuar prej Korrik 2024 me miratimin e Strategjisë Kombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ndërkohë pika e dytë realizimi i planit të veprimit të Vlerësimit kombëtar të Rrezikut është në proces zbatimi me afat përfundim vitin 2027.

Të dy dokumentet monitorohen mbi baza katër mujore nga GTNP me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve publike dhe përfaqësuesve të sektorit privat.

Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

“Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024 - 2030 dhe plani i saj i veprimit” u hartua në partneritet të ngushtë midis përfaqësuesve të institucioneve publike dhe përfaqësuesve të sektorit privat, anëtarë të GTNP, në zbatim të vendimit nr. 1 datë 27.12.2023 të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

Falë mbështetjes të GIZ në Shqipëri dhe Zyrës në Tiranë të Këshillit të Evropës dokumenti i strategjisë u rishikua nga dy ekspertë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke e përafëruar këtë dokument me standardet më të mira ndërkombëtare në luftën kundër PP/FT. Dokumenti i Strategjisë Kombëtare është përkthyer edhe në anglisht. Strategjia është një dokument gjithëpërfshirës dhe në planin e veprimit (2024 – 2027) ka 6 objektiva kryesorë dhe 50 masa ku ngarkon të gjithë anëtarët e GTNP duke përfshirë edhe sektorin privat për realizimin e masave, në përputhje me fushën e tyre të veprimit.

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR PARANDALIMIN E *Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit*

2024-2030



Korrik 2024

Në funksion të realizimit të masave të parashikuara nga AIF si institucion koordinues janë dërguar shkresa zyrtare apo edhe komunikime elektronike me institucionet e përfshira.

Përmbushja në kohë e masave të parashikuara në Planin e Veprimit, kërkon një angazhim konstant dhe raportimi periodik (çdo 4 muaj) nga çdo institucion i përfshirë, marrë në konsideratë se përmbushja e masave të këtij plani veprimi është tregues i efektivitetit në vend në fushën PP/FT, tregues që pritët të vlerësohet edhe nga Komiteti Moneyval në kuadër të Raundit të 6-të të vlerësimit të Shqipërisë.

Gjatë vitit 2025 është realizuar pjesa më e madhe e masave që parashikojnë afat brenda këtij viti, ndër të cilat më kryesoret në mënyrë të përmbledhur janë:


- Krijimi dhe funksionimi i grupeve ndërinstitucionale për t'u fokusuar në sektorë me rrezik të lartë, duke kombinuar ekspertizën nga rregullatorët, agjencitë e zbatimit të ligjit, sektorin privat dhe agjenci të tjera lidhur me PPP/FT;
- Konsolidimi i bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet zgjerimit të numrit të institucioneve dhe subjekteve raportues që marrin pjesë në takimet e GTNP
- Hartimi dhe zbatimi i një plani trajnimesh gjithëpërfshirës nga institucionet publike, autoritet mbikëqyrëse dhe përfaqësuesit e sektorit privat.

Nga 50 masa që përmban strategjia kombëtare, për vitin 2025, 40 masa janë realizuar plotësisht dhe 10 masa janë në proces me afat zbatimi vitin 2026.

Tabelë 13: Monitorimi i Planit të Veprimit për vitin 2025

Objektivi	Realizuar	Në proces	Pa veprim/ Pa raportim	Total
Objektivi 1	7	1	-	8
Objektivi 2	7	1	-	8
Objektivi 3	9	3	-	12
Objektivi 4	7	2	-	9
Objektivi 5	4	3	-	7
Objektivi 6	6	-	-	6
Total	40	10	0	50

Grafik 3: Planit i Veprimit për vitin 2025



Plani i Veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut për PP/FT (NRA)

Ka vijuar puna për ndjekjen dhe zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut për PP/FT i cili është ka një shtrirje kohore 3 vjeçare dhe përmban 48 masa.

Gjatë vitit 2025 është realizuar pjesa më e madhe e masave të planit të veprimit me afat përmbushje brenda këtij viti, ndër të cilat më kryesoret në mënyrë të përmblodhur janë:


- Janë përgatitur dhe shpërndarë për sektorin privat dhe publik dy dokumente përmblledhëse mbi indikatorë dhe tipologji që lidhen me vepra penale të korrupsionin dhe me evazionin fiskal;
- Janë organizuar trajnime të mëtejshme me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve ligj zbatuese, të inteligjencës dhe të mbikëqyrjes;
- Janë realizuar takime ndërinstitucionale pranë Prokurorive së Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Vlorë, Durrës, Fier, Tiranë me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktika të mira.

Nga 48 masa që përmban Plani i veprimit të NRA, për vitin 2025, 40 masa janë realizuar plotësisht dhe 7 masa janë në proces me afat zbatimi vitin 2026 dhe vetëm 1 masë është ende pa veprim.

Tabelë 14: Monitorimi i Planit të Veprimit të NRA për vitin 2025

Monitorimi i planit të veprimit Janar - Dhjetor 2025				
Objektivi	Realizuar	Në proces	Pa veprim/ Pa raportim	Total
Objektivi 1	14	1		15
Objektivi 2	6			6
Objektivi 3	4			4
Objektivi 4	1	1		2
Objektivi 5	3	1		4
Objektivi 6		1		1
Objektivi 7	4			4
Objektivi 8	4	3	1	8
Objektivi 9	2			2
Objektivi 10	2			2
Total	40	7	1	48

Grafik 4: Planit i Veprimit të NRA për vitin 2025



Strategjia për edukimin e publikut mbi rrezikun e PP/FT në shoqërinë tonë

Në kuadër të zbatimit të “Strategjisë për edukimin e publikut mbi rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në shoqërinë tonë” janë organizuar 10 takime mbi edukimin financiar, konkretisht me:

- Dhomën Kombëtare të Noterëve, datë 31.01.2025;
- Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, datë 05.02.2025;
- Shoqatën e Ndërtueseve e Shqipërisë, 11.02.2025;
- Shoqatën Shqiptare të Bankave, datë 12.02.2025;
- Shoqatën Shqiptare të Këmbimit Valutor, datë 18.02.2025;
- Mikrofinanca Shqiptare, datë 20.02.2025;
- Shoqatën e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme, datë 25.02.2025;
- Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, datë 28.03.2025.

Qëllimi i këtyre takimeve është ndërgjegjësimi i opinionit publik për çështjet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PP/FT) dhe forcimi i bashkëpunimit me sektorin privat duke pasur në vëmendje edukimin e klientëve për çështjet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PP/FT), si dhe rrezikun që mbart ky fenomen në shoqërinë tonë.

Gjithashtu, në datë 21 Maj 2025, AIF në bashkëpunim me Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA) dhe me DHTIT zhvilluan një tryezë diskutimi mbi “Strategjinë e edukimit të publikut mbi rrezikun që mbart në shoqërinë tonë pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit 2025–2027” duke u përqendruar në rolin që duhet të luajnë jo vetëm institucionet shtetërore, por edhe shoqëria civile, institucionet arsimore, media dhe sektori privat.

Në datë 30 Tetor 2025, AIF në bashkëpunim me EMA organizuan një tjetër takim në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Evropian me temë “Edukimi financiar Kapitulli 24 – Në kuadër të ‘Strategjisë së Edukimit të Publikut mbi rrezikun që mbart PP/FT’. FinTech, Risitë dhe Rreziqet në Luftën Kundër Pastrimit të Parave”.

Takimi u fokusua në sfidat dhe mundësitë që ofron teknologjia financiare në PPP/FT/ADM, si edhe në trajtimin e çështjeve që lidhen me dezinformimin, një problematikë me ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare.

Strategjia Institucionale e Agjencisë të Inteligjencës Financiare 2023–2027

Agjencia e Inteligjencës Financiare, në Dhjetor 2022 miratoi “Strategjinë Institucionale” 2023 - 2027, rishikuar në Shtator 2025, me fokus në forcimin e kapaciteteve analitike dhe operacionale, zbatimin efektiv të kuadrit ligjor e rregullator, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, ndërgjegjësimin e subjekteve raportuese, si dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore.

Në kuadër të monitorimit të Planit të Veprimit të kësaj strategjie, rezultoi se gjatë vitit 2025 janë realizuar 63 masa nga 70 masa gjithsej.

Ndër masat në proces përfshihen sigurimi i licencave të reja për programet analitike, rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve të sektorit FINTECH, digjitalizimi i procedurave të ekzekutimit të masave administrative, si dhe rishikimi dhe përshtatja në vazhdimësi e manualeve të brendshme të punës.



AIF do të vijojë zbatimin e strategjisë institucionale me të njëjtin rritëm edhe për vitin 2026.

Bashkëpunimi ndër-institucional


Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional, AIF shkëmben informacion dhe ka korrespondencë të vazhdueshme dhe intensive për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprave penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale apo financimit të terrorizmit me institucionet e sistemit të drejtësisë penale dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës.

Gjatë vitit 2025, janë trajtuar në total 906 kërkesa për informacion të ardhura nga Policia e Shtetit, Prokuroritë, SPAK etj., me të cilat është kërkuar informacion për 5,519 persona dhe subjekte. Të dhëna të detajuara gjenden në tabelën më poshtë:

Tabelë 15: Numri i kërkesave të dërguara nga Policia e Shtetit dhe Prokuroritë për 2025.

Institucioni	Nr. Kërkesash	Nr. Personave
Policia e Shtetit	377	1,666
Prokuroritë	492	3,334
SPAK	57	524
BKH	7	72
TOTAL	933	5,596

Grafik 5: Numri i kërkesave për verifikime dhe numri i personave të përfshirë ndër vite



Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e punës së AIF, vijon të jetë shkëmbimi i informacionit me institucionet e tjera në kuadër të proceseve të vlerësimit apo të procedurave të licencimit në funksionin e autoriteteve mbikëqyrëse si: Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP), KLGJ, KLP, BSH, AKSIK, AKKC, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM), etj., kërkesa për të cilat AIF është impenjuar maksimalisht për të respektuar afatet ligjore të kthimit të përgjigjeve.

Gjithashtu, AIF ka kthyer përgjigje për kërkesat e paraqitura nga Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme dhe Ministria e Drejtësisë, lidhur me reputacionin e të emëruarve pjesë e trupës diplomatike apo aplikantëve si ndërmjetësues të pasurive të paluajtshme. Të dhënat për shkëmbimin e informacionit me institucionet e sipërpërmendura paraqiten në mënyrë të detajuar në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 16: Numri i kërkesave nga organet e tjera ligj zbatuese.

Institucioni	Nr. Kërkesave	Nr. Personave
Ministri	95	866
BSH	88	201
KLJG	5	68
KLP	45	57
AKSIK	9	12
AKKC	8	16
AMP	50	196
AISM	14	27
DPT	3	11
SHISH	16	46
Komisioni i Posaçëm ¹	23	33
Avokate/Studio ligjore	2	3
Total	358	1,536

¹ Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës (DPPSH)

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Shkëmbimi i informacioneve me NJIF

Gjatë këtij viti, krahasuar me vitin 2024, ka pasur një rritje prej rreth 15 % të kërkesave të dërguara nga AIF, si edhe një rritje të ndjeshme prej 24% të kërkesave që AIF ka marrë nga NjIF partnere.

Tabelë 17: Numri i kërkesave dhe përgjigjeve me NjIF partnere ndër vite.

Viti	Të dërguara nga AIF	Të marra nga NjIF partnere
2021	82	107
2022	101	108
2023	92	85
2024	113	93
2025	130	115

Komiteti Moneyval i KiE

Më datat 12-13 qershor 2025, AIF mori pjesë në mbledhjen e 69-të plenare të Komitetit Moneyval, e cila u zhvillua në Strasbourg, në selinë e Këshillit të Evropës, ku u diskutuan Raporte të Vendeve anëtare në proces vlerësimi dhe zhvillimet e fundit në kuadër të zbatimit të standardeve të FATF.

AIF mori pjesë gjithashtu në datat 15–18 dhjetor 2025, në mbledhjen e 70-të plenare të Moneyval, në të cilën u diskutuan çështje kyçe që lidhen me vlerësimin dhe forcimin e sistemeve kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, shqyrtimi dhe diskutimi i projekt-raportit të vlerësimit të ndërsjellë të raundit të 6-të të vendeve në vlerësim, si dhe përditësimet mbi zhvillimet dhe iniciativat ndërkombëtare në kuadër të standardeve të FATF.

Gjithashtu, plenarja trajtoi miratimin e rregullave të procedurës për raundin e 6-të të vlerësimeve, përgatitjen e një protokolli për Konventën e Këshillit të Evropës për pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve kriminale, si dhe zhvillimet në kuadër të iniciativave PPP/FT në organizata të tjera ndërkombëtare.

Në këtë kuadër u zhvilluan edhe zgjedhjet për Kryetarin, Zëvendëskryetarët dhe anëtarët e Byrosë së Moneyval, si dhe u trajtuan çështje që lidhen me procesin e vlerësimeve të ndërsjella, trajnimet e vlerësuesve, tipologjitë e pastrimit të parave dhe aspektet organizative.

Trajnimi nga Komiteti Moneyval

Në datat 11–12 mars 2025, u zhvillua një trajnim dyditor nga dy përfaqësues të Sekretariatit të Komitetit Moneyval, në kuadër të raundit të 6-të të vlerësimit të Shqipërisë. Në këtë trajnim, morën pjesë rreth 120 pjesëmarrës, anëtarë të GTNP, përfaqësues të institucioneve publike, përfshirë institucionet ligj zbatuese dhe ato mbikëqyrëse, si dhe përfaqësues të sektorit privat.

Pjesëmarrësit në këtë trajnim, janë njohur me procedurat dhe afatet e vlerësimit të raundit të 6-të, si dhe ndryshimet kryesore të standardeve dhe metodologjisë së FATF (standardet kundër pastrimit të parave që shërbejnë si bazë për vlerësimin e shteteve në nivel ndërkombëtar) dhe morën pjesë në sesione simuluese, në lidhje me procedimet penale për PP/FT, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive kriminale, mbikëqyrjen

dhe kontrollin e lidhjeve të mundshme kriminale të profesioneve të lira jo financiare si dhe mekanizmat për mbikëqyrjen e zbatimit të sanksioneve financiare për personat dhe subjektet e shpallura si financues të terrorizmit.

Në këtë aktivitet, përfaqësues të AIF, QKB, BSH dhe AMF, paraqitën prezantime sipas sektorëve përkatës, në lidhje me vlerësimin e riskut, transparencën e të dhënave të pronarëve përfitues, mbikëqyrjen e institucioneve financiare dhe ofruesve të shërbimeve të mjeteve virtuale. Në përfundim të sesioneve, u dhanë komente dhe sugjerime të vlefshme për raportimin e mëtejshëm gjatë procesit të vlerësimit, si dhe për ndërhyrjet e nevojshme përmirësuese në sistemin parandalues PP/FT/ADM.

Grupi Egmont

Në datat 6 -11 Korrik 2025, AIF mori pjesë në mbledhjen e 31-të Plenare të Grupit Egmont, të organizuar nga NJIF e Luksemburgut. Kjo mbledhje, ofroi një mundësi për të forcuar partneritetet ekzistuese, për të ndërtuar bashkëpunime të reja dhe për të kontribuar në iniciativa që përmirësojnë përpjekjet globale kundër krimit financiar. Përfaqësuesit e NJIF zhvilluan diskutime të rëndësishme në grupe të ndryshme pune dhe forumet rajonale.

Takimi Rajonal i NJIF

AIF mori pjesë në Takimin Rajonal të NJIF, i cili u zhvillua më datën 20 nëntor 2025, në Shkup të Maqedonisë së Veriut.

Gjatë takimit, u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe atë me BE në fushën e luftës kundër PP/FT, përfshirë bashkëpunimin me platformën FIU.net dhe zhvillimet lidhur me krijimin e Autoritetit të ri Evropian kundër Pastrimit të Parave (AMLA).

Në këtë takim u zhvillua dhe ceremonia e nënshkrimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit, në kuadër të Programit Rajonal të Shkëmbimit të ekspertëve të NJIF. Në takim u trajtuan gjithashtu zhvillimet dhe përgatitjet lidhur me Raundin e 6-të të vlerësimeve të Moneyval, për sistemet kundër PP/FT.

Agjencia e Inteligjencës Financiare mori pjesë në takimin rajonal të Europe II të Grupit Egmont, i cili u zhvillua në datat 3–5 dhjetor 2025, në Prishtinë. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të NJIF nga vendet e rajonit, në të cilin u diskutua për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal në luftën kundër PP/FT. Gjithashtu, gjatë sesioneve të punës, u trajtuan çështje që lidhen me shkëmbimin e informacionit ndërmjet NJIF, zhvillimet e fundit në kuadër të standardeve ndërkombëtare të PPP/FT dhe përgatitjet për proceset e vlerësimit ndërkombëtar.

Takimi shërbeu gjithashtu si një platformë për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira ndërmjet vendeve pjesëmarrëse, me qëllim rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit operacional dhe koordinimit në nivel rajonal.

Takim koordinues me partnerët ndërkombëtarë

Në datën 18 Qershor 2025, AIF organizoi një takim koordinues me partnerët ndërkombëtarë mbi Planet e Veprimit të “Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030” dhe “Vlerësimit Kombëtar të Riskut” me synim koordinimin e ndihmës dhe mbështetjes për zbatimin e masave të këtyre dokumenteve strategjike.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga: Delegacioni i BE në Shqipëri, Këshilli i Evropës, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasada Britanike, Ambasada Zviceriane, Ambasada Italiane, Ambasada Gjermane, Ambasada Franceze, GIZ, Projekti EU4LEA2, Korpusi i Vullnetarëve të Shërbimeve Financiare si dhe Lëvizja Evropiane në Shqipëri. Në këtë takim AIF theksoi rolin thelbësor, në bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për përmirësimin e kapaciteteve dhe rritjen e qëndrueshmërisë institucionale.

Gjatë takimit, u pasqyruan të dhënat mbi rezultatet e masave të realizuara për dokumentet strategjike dhe Planin e Veprimit të vlerësimit kombëtar të riskut PP/FT nga institucionet publike dhe sektori privat. Partnerët ndërkombëtarë, vlerësuan angazhimin, transparencën dhe efektivitetin e deritanishëm të procesit, duke rikonfirmuar gatishmërinë e tyre për vijimin e mbështetjes për AIF.

NDRYSHIME LIGJORE

Në funksion të ndryshimeve ligjore të ligjit Nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, gjatë vitit 2025 AIF ka përgatitur projekt vendimin “Për formën, mënyrën dhe procedurën e raportimit të të dhënave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”, i cili është konsultuar me institucionin e linjës sipas fushës së përgjegjësisë:

Në vijim paraqiten aktet nënligjore të miratuara gjatë vitit 2025:

- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.1 datë 21.01.2025 “Për mënyrat dhe procedurat për zbatim nga subjektet e përfshira në veprimtari financiare”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 3 datë 24.01.2025 “Për mënyrat dhe procedurat për zbatim nga bizneset dhe profesionet e caktuara jo financiare”.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.665, datë 12.11.2025, “Për përcaktimin e autoriteteve mbikëqyrëse”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr.668, datë 12.11.2025, “Për formën, mënyrën dhe procedurën e raportimit të të dhënave nga autoritetet licencuese dhe mbikëqyrëse”;
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.25, datë 11.11.2025 “Për mënyrat dhe procedurat për raportim nga organet doganore”.

AIF ka dhënë mendime ligjore dhe ka kontribuar në procesin e konsultimit ndërinstitucional për një sërë projekt aktesh ligjore dhe nënligjore.

Këto kanë përfshirë iniciativa në fusha të ndryshme, si: strategjitë kombëtare për mbrojtjen e interesave financiare të BE, shqyrtimin e investimeve të huaja direkte, rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë financiare (përfshirë zyrat e këmbimit valutor dhe shkëmbimin automatik të informacionit financiar), si dhe projektligje që lidhen me funksionimin e sistemit financiar dhe të tregut të biznesit.

Gjithashtu, AIF ka dhënë mendim për një sërë projektligjesh që lidhen me kuadrin ligjor të veprimtarisë tregtare dhe të biznesit, përfshirë ndryshime në legjislacionin për shoqëritë tregtare, regjistrimin e biznesit dhe organizatave jofitimprurëse, funksionimin e QKB, si dhe iniciativa të tjera ligjore me rëndësi për transparencën, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe forcimin e kuadrit rregullator.

BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE TI


Buxheti dhe menaxhimi i tij

Gjatë vitit 2025, AIF ka shpenzuar në total rreth 174.4 milionë lekë, ose 24% më shumë krahasuar me vitin 2024. Realizimi i shpenzimeve rezultoi në masën 90% të fondit të alokuar për 2025. Shpenzimet ishin të ndara, 170.3 milionë lekë shpenzime korrente dhe 4.1 milionë lekë shpenzime kapitale. Raporti i shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale, ndaj totalit ishte respektivisht 97.6 % dhe 2.4%, përafërsisht në të njëjta nivele raportesh si në 2024. Shpenzimet korrente u realizuan në masën 95% të planit buxhetor dhe shpenzimet kapitale në masën 28% të planit buxhetor respektiv. Fondet për investime u përdorën për plotësimin e nevojave për krijimin e kushteve të punës për punonjësit sipas standardeve. AIF do vijojë të jetë e angazhuar në menaxhimin aktiv të buxhetit, transparencën dhe përmirësimin e procesit të planifikimit, duke synuar rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike të alokuara, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës së TI, duke mundësuar zbatimin dhe arritjen e objektivave institucionale, për parandalimin e PP/FT/ADM.

Menaxhimi i burimeve njerëzore

Struktura organizative e AIF është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 45 datë 19.03.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AIF”, në përbushje të së cilës gjatë 2025, kanë vijuar të zbatohen procedurat e rekrutimit dhe vënien në efikasitet të plotë të saj. Si pjesë e objektivave prioritarë, rëndësi i është kushtuar rritjes së kapaciteteve profesionale të punonjësve dhe përfitimit të njohurive të reja në fushën e parandalimit të PP/FT/ADM, nëpërmjet organizimit të trajnimeve të ndryshme, të financuara nga buxheti i AIF, donatorë si dhe organizma ndërkombëtarë me të cilët AIF bashkëpunon. Gjatë 2025, 38 punonjës të AIF kanë marrë pjesë në 52 trajnime, në të cilët janë trajtuar temat për: Hetimi mbi monedhat virtuale; Standardet ndërkombëtare të FATF; Hetimi financiar; Goditja e rrjeteve ndërkombëtare profesionale të pastrimit të parave; Antikorrupsioni dhe rikuperimi i pasurive; Standardet, funksionet, dhe mbikëqyrja mbi baza risku për PP/FT/ADM; Përdorimi i mjeteve virtuale për financimin e terrorizimit; Pastrimi i parave dhe rikuperimi i pasurive; Metodatat dhe teknikat analitike për hetimin e PP/FT; Informimi dhe ndërgjegjësimi mbi teknologjinë financiare (Fintech), Risitë dhe Rreziqet që ato sjellin në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave etj. AIF, në kuadër edhe të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë për arritjen e objektivave në luftën kundër PP/FT/ADM, do të vazhdojë të ndjekë politika prioritare për përmirësimin e kapaciteteve profesionale, të bazuara jo vetëm në rritjen në numër të strukturës organizative por dhe në rritjen profesionale të punonjësve nëpërmjet ofrimit të mundësive dhe përfshirjes në trajnime.

Organigrama e AIF:



TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) ka garantuar funksionimin e qëndrueshëm të sistemeve informatike dhe ka mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë proceset analitike dhe operacionale të AIF. Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- Administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të raportimit elektronik (RAD, RTPF);
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës së serverëve, databazave, Domain Controller dhe Exchange Server;
- Upgrade të firmware dhe sistemeve operative për pajisjet e rrjetit (firewall, switch, FMC, FTD);
- Monitorimin dhe mbrojtjen e rrjetit kompjuterik;
- Administrimin e kopjeve rezervë (backup) dhe sigurisë së të dhënave;
- Mirëmbajtjen e platformave të postës elektronike (publike dhe sekrete);
- Përditësimin dhe administrimin e faqes zyrtare të AIF;
- Publikimin e dokumenteve të FATF, tipologjive PP/FT dhe Programit të Transparencës;
- Mbështetjen teknike për hartimin dhe publikimin e Raportit Vjetor 2024.

ANGAZHIMET NDËRINSTITUCIONALE

DTI ka konsoliduar dhe administruar shkëmbimin elektronik të informacionit me:

- DPPSH (TIMS, FER, SIENA);
- DPGJC (Regjistri i Gjendjes Civile);
- DPT (C@TS, Regjistri Qendror i Llogarive Bankare, Fiskalizimi);
- DPD (Import/Eksport, Deklarimet);
- Dhoma Kombëtare e Noterisë (NISA);
- QKB (Regjistri i Bizneseve);
- ILDKPKI (Listat PEP);
- ASHK (Regjistri Kadastral);
- MD (Regjistri i Gjendjes Gjyqësore);
- Egmont Secure Web (ESW);
- AKSK dhe AKSHI për çështje të sigurisë dhe infrastrukturës.

Në 2025, DTI ka marrë pjesë aktive në trajnime dhe projekte me EU4FOCAL, GIZ dhe partnerë ndërkombëtarë. Gjithashtu DTI ka marrë pjesë në Trajnime dhe Webinar që janë organizuar nga AKSK që ka pasur për synim të rrisë kapacitetet teknike në Menaxhimin e Incodenteve dhe Krizës Kibernetike, gjithashtu të rrisë kapacitetet teknike në përdorimin e teknologjive alternative me platforma Open Source.

Aritjet më të rëndësishme gjatë vitit 2025:

Forcimi i sigurisë kibernetike

- Implementimi i Web Application Firewall (FortiWeb);
- Implementimi i sistemit SIEM (Elastic);
- Rinovimi i licencave Cisco dhe upgrade i pajisjeve të rrjetit;
- Konsolidimi i Bitdefender GravityZone;
- Përditeësimi i Domain Controller;
- Përmbushja e rekomandimeve të AKSK pas vlerësimit të riskut.

Stabiliteti operacional

- Garantimi i funksionimit të pandërprerë të sistemit të raportimit online;
- Administrimi i sigurt i kalimit të raportimeve nga DMZ në zonën sekret;
- Konsolidimi i komunikimit përmes Egmont Secure Web;
- Mbështetje teknike e vazhdueshme për subjektet raportuese.

Digjitalizimi dhe transparenca

- Përditësimi i faqes së re zyrtare;
- Publikimi periodik i dokumenteve strategjike dhe ligjore;
- Përditësimi i Programit të Transparencës.

Rritja e kapaciteteve

- Aftësimi profesional i personelit të AIF;
- Pjesëmarrje në trajnime të specializuara të AKSK;
- Rritje e kapaciteteve teknike në fusha si SIEM, WAF, IDS/IPS, EDR.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026

Në vijim paraqiten objektivat e AIF për vitin 2026.

- Koordinimi ndërinstytucional i procesit të raundit të 6-të të vlerësimit të vendit nga komiteti Moneyval për çështjet e parandalimit të PP/FT;
- Drejtimi i Grupit Teknik Ndërinstytucional të Punës;
- Koordinimi dhe ndjekja e “Strategjisë kombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2030” dhe planit të veprimit;
- Koordinimi dhe ndjekja e planit të veprimit për zbutjen e rreziqeve të identifikuara në Vlerësimin Kombëtar të Riskut për PP/FT;
- Koordinimi dhe ndjekja e “Strategjisë të edukimit të publikut për rrezikun që mbart pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në shoqërinë tonë”;
- Harmonizimi i kuadrit ligjor me direktivat dhe rregulloret e BE;
- Përmirësimi i efikasitetit operacional të organeve ligj zbatuese dhe agjencive të tjera në luftën kundër PP/FT;
- Zhvillimi i kapaciteteve teknologjike të AIF;
- Forcimi i bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Zbatimi i planit të integruar të trajnimeve nëpërmjet rritjes së kapaciteteve institucionale;
- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve në drejtim të mbikëqyrjes mbi bazën e rrezikut të PP/FT, në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse;
- Rritja e bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional në funksion të efektivitetit të sistemit parandalues dhe trajtimit me efikasitet të rasteve të shpërndara nga AIF për organet e zbatimit të ligjit;
- Njohja me praktikat më të mira ndërkombëtare të FATF dhe zbatimi i tyre në fushën e përputhshmërisë së subjekteve;
- Pjesëmarrja aktive në projektet ndërkombëtare (KiE, BE, GIZ, Departamenti i Shtetit të SHBA etj.);
- Trajnimi i subjekteve të ligjit duke u fokusuar në ndryshimet e ligjit 9917, aktet nënligjore, vlerësimin e riskut PP/FT dhe zbatimin efektiv të sanksioneve ndërkombëtare;

SHTOJCA I

TIPOLOGJI TË RASTEVE TË DËRGUARANË ORGANET LIGJZBATUESE

Tipologjia 1

Përdorimi i llogarive personale për aktivitet tregtar të paregjistruar, i shoqëruar me depozitime të shpeshta parash.

Shtetasi Shqiptar A ka hapur llogari në bankën Z dhe gjatë periudhës 2024–2025, në llogaritë e tij janë konstatuar depozitime rreth 300,000 EUR nga vetë shtetasi A, ashtu edhe nga disa shtetas të tjerë. Nga verifikimet e kryera në regjistrin e gjendjes civile rezulton se një pjesë e këtyre personave kanë marrëdhënie familjare midis tyre, si motër, vëlla dhe kushërinj.

Në vijim janë kryer verifikime të tjera pranë bankave të nivelit të dytë për llogaritë bankare të të gjithë shtetasve të përfshirë në këtë aktivitet. Nga këto verifikime rezultoi se gjatë së njëjtës periudhë kohore janë depozituar, në total, rreth 1,900,000 EUR.

Sipas të dhënave të administruara, skema ka funksionuar si më poshtë:

- Shtetasi A, së bashku me 9 shtetas të tjerë, janë pajisur me karta të parapaguara, të cilat janë përdorur për blerjen e produkteve të markave të luksit, në shtete të ndryshme.
- Këta shtetas kryenin depozitime në llogaritë e tyre personale ose në llogaritë e njëritjetrit, ndërsa më pas një pjesë e konsiderueshme e fondeve transferohej në karta të llojit Mastercard.
- Nga analiza e përdorimit të këtyre fondeve rezulton se ato janë shfrytëzuar kryesisht për kryerjen e blerjeve online.
- Përveç depozitimeve, llogaritë bankare janë kredituar gjithashtu me një shumë të konsiderueshme, rreth 350,000 EUR, si rimbursimi i TVSH-së përmes kompanive “Planet Tax Free” dhe “Global Blue Tax Free”. Edhe këto fonde janë përdorur për kryerjen e blerjeve të produkteve të markave të ndryshme.

Nga verifikimet e kryera në QKB dhe sistemin tatimor rezulton se shtetasi A ka regjistruar në vitin 2024 subjektin X, me objekt veprimtarie ‘shitje veshjesh online’.

Sipas të dhënave të deklaruara, për vitin 2024 subjekti ka raportuar zero të ardhura, ndërsa në fillim të vitit 2025 aktiviteti është çregjistruar. Gjithashtu, janë kryer verifikime edhe për shtetasit e tjerë të përfshirë, nga të cilat rezultojnë të dhëna vetëm mbi statusin e tyre të punësimit.


Nga këto verifikime evidentohet se disa prej tyre kanë qenë të punësuar në të njëjtat shoqëri me aktivitet të palidhur me veprimtarinë më lart.

Bazuar në dyshimet e krijuara nga analiza e të dhënave, konkretisht:

- Qarkullimi i vlerave të konsiderueshme përmes sistemit bankar, të cilat rezultojnë të jenë të lidhura me ushtrimin e një aktiviteti të tregtisë online të pajisur;
- Përfitimi i rimbursimit të TVSH-së, ndërkohë që nuk rezulton të jetë paguar TVSH për importin e mallrave në Shqipëri;
- Mungesa e të ardhurave të deklaruar individuale nga shtetasit e përfshirë, të cilat do të mund të justifikonin depozitimet e kryera,

Informacioni u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Skema



Tipologjia 2

Investime në pasuri të paluajtshme me burime fondesh të panjohura ose të pajustificuara

Shtetasi A përgjatë viteve 2021 – 2025, rezulton i përfshirë në një sërë aktesh noteriale nëpërmjet të cilave ka përfituar pasuri të paluajtshme në zona të ndryshme të Tiranës dhe Kavajës.

Fillimisht, në vitin 2021 ka investuar në qytetin e Kavajës ku brenda një periudhë 3 mujore ka blerë 7500 m² truall kundrejt vlerës 260,000 EUR dhe ka përfituar nëpërmjet dhurimit 1500 m². Me tej, në vitin 2022 blerë në zonën e Prezës 8400 m² me 520 Lekë/m². Ndërsa gjatë vitit 2023 – 2025 ka kryer numrin më të lartë të investimeve, në zonën e Dajtit në Tiranë, ku përmes kontratave të shitblerjes së pasurive të paluajtshme ka përfituar 56,000 m² ‘tokë arë’ me çmim për m² që variojn nga 4 – 21 EUR.

Në vijim, përveç anomalisë së mësipërme lidhur me përfitimin e pasurive me çmime më të ulëta se niveli i tregut, janë konstatuar edhe raste kur këto pasuri janë rishitur brenda një periudhe të shkurtër kohore me vlera ndjeshëm më të larta.

- Konkretisht, në mars 2022 shtetasi A i ka shitur shtetasit B një pasuri të paluajtshme të llojit ‘tokë arë’ me sipërfaqe 6,200 m² kundrejt vlerës 423,000 EUR, ndërkohë nga verifikimet rezulton se vetëm pak muaj më parë e kishte blerë nga një shtetas tjetër në vlerë 30,000 EUR.
- Po në të njëjtën datë është realizuar edhe një transaksion tjetër i ngjashëm, ku shtetasi A i ka shitur shtetasit B një pasuri të paluajtshme të llojit ‘tokë arë’ me sipërfaqe 1,850 m² kundrejt vlerës 180,000 EUR, të cilën vetëm pak muaj më parë e kishte blerë vetëm 15,000 EUR.

Gjithashtu, në të njëjtën zonë ku shtetasi A ka përfituar pjesën më të madhe të pasurive me çmime relativisht të ulëta (4–21 EUR/m²), rezultojnë te jenë kryer dhe transaksione me shoqërinë “X”, nga e cila shtetasi A, ka blerë pasuri të paluajtshme të llojit ‘tokë arë’ me një çmim dukshëm më të lartë, rreth 75 EUR/m².”

Krahas investimeve të shumta të kryera në cilësinë e individit, nga verifikimet rezulton se shtetasi A ka regjistruar në vitin 2022 edhe shoqërinë “Beta”, me objekt veprimtarie në fushën e ndërtimit dhe gjurmimit, nëpërmjet të cilës ka përfituar sipërfaqe të konsiderueshme pasurish të paluajtshme në zonat e Petrelës dhe Mulletit, konkretisht rreth 52,000 m² në Petrelë dhe 16,000 m² në Mullet.

Nga analiza e akteve të blerjes është konstatuar e njëjta anomali në mënyrën e përfitimit të këtyre pasurive transaksione me çmime tepër të ulëta për m².

Nga analiza e pasqyrave financiare, librave të shitjes dhe blerjes, rezulton se kjo shoqëri, ndonëse e krijuar rishtazi, ka shfaqur një aktivitet financiar të konsiderueshëm që në vitin e dytë të operimit.

Sipas të dhënave të deklaruara shoqëria Beta:

- Ka raportuar fitime që arrijnë deri në rreth 1,700,000 EUR, ku pjesa më e madhe e tyre është kaluar në rezerva, ndërsa shpërndarja e dividendit ka qenë relativisht e ulët, rreth 70,000 EUR.
- Ka pasur që në vitin e parë të aktivitetit një numër të konsiderueshëm makinerish të regjistruara në pronësi, element i cili ngre dyshime lidhur me burimin e financimit apo mënyrën e përfitimit të tyre.

Nga verifikimet e kryera mbi burimin e të ardhurave të përdorura për realizimin e investimeve rezulton se shtetasi A ka përdorur si burim financimi fonde të përfituara nga shitja e pasurive të paluajtshme në vlerë 423,000 EUR dhe 180,000 EUR.

Përveç këtyre, janë evidentuar edhe kalime fondesh nga llogaria e shoqërisë “X” si pagesa ndërmjetësimi në negociimin me pronarin e truallit si dhe transfertat nga llogaria e shoqërisë së tij “Beta”.


Ndërsa në llogaritë e shoqërisë “Beta” ka pasur kreditime të shumta për likuidim faturash dhe disburime kredish, Këto fonde janë përdorur pjesërisht për aktivitetin e shoqërisë dhe pjesërisht për likuidimin e kontratave të shitblerjes së pasurive të paluajtshme.

Nga verifikimet e kryera në ASHK në pronësi të shtetasis A dhe shoqërisë “Beta” rezulton një numër i lartë pasurish të paluajtshme.

Duke marrë në konsideratë:

- Numrin e lartë të transaksioneve me pasuri të paluajtshme ku pjesa më e madhe janë blerë me çmim dukshëm më të ulët se çmimi i tregut, ngrihen dyshime për burimin real të pagesave për blerjen e tyre;
- Dy prej pronave janë blerë me çmim tepër të ulët dhe janë rishitur brenda një periudhë të shkurtër kohore në vlerë disa herë më të lartë;
- Investimet në pasuri të paluajtshme kanë filluar në vitin 2021 vijuar më tej 2022 -2023, ndërkohë aktiviteti i biznesit ka filluar rritjen në vitin 2023;
- Rritja e shpejtë e aktivitetit të biznesit, e shoqëruar me volum të lartë transaksionesh shitje-blerje, si dhe investime të konsiderueshme në makineri dhe pajisje,

rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.



Tipologjia 3

Investime të dyshimta në pasuri të paluajtshme dhe vepra arti nga burime ndërkombëtare fondesh dhe kompani të regjistruara në juridiksione me lehtësira fiskale.

Shtetasit A dhe B, me shtetësi shqiptare dhe kombësi të huaj, gjatë vitit 2025 kanë kryer blerje të pasurive të paluajtshme dhe veprave të artit në territorin e Republikës së Shqipërisë, në vlera të larta, duke përdorur fonde të ardhura nga juridiksione dhe biznese të regjistruara në juridiksione me lehtësira fiskale, që rrisin kompleksitetin dhe dyshimet mbi origjinën e fondeve.

Konkretisht në Shkurt 2025, shtetasja A, 18 vjeç, ka blerë një vilë në bregdet me vlerë 1.5 milion EUR. Sipas të dhënave të administruara, financimi për realizimin e kësaj blerjeje është siguruar nga motra e saj, shtetasja B.

Shtetasja B, 40 vjeç, rezidente në një vend i cili ka lehtësira fiskale X, ka mbështetur këtë investim përmes fondeve të mbërritura nga një llogari bankare e saj në një shtet të Afrikës Jugore (AF1), i konsideruar me risk të shtuar në lidhje me korrupsionin dhe ekonominë informale.

Më tej gjatë vitit 2025, shtetasja B ka blerë një vilë në bregdet me vlerë 1.7 milion EUR, e financuar nga një llogari personale në një vend po me lehtësira fiskale (Z).

Gjithashtu, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, shtetasja B rezulton të ketë investuar në Shqipëri edhe në blerjen e veprave të artit me vlerë rreth 700,000 EUR.

Sipas të dhënave që disponojmë, shtetasja B është ortake e vetme e një biznesi (B1), që operon në sektorin e lojërave online në Seychelles (ku kjo e fundit është ortake e një kompanie të regjistruar në shtetin Z, shoqëria B2, me të njëjtën fushë aktiviteti).

Të ardhurat e përfituara nga shpërndarja e dividendit kanë kaluar në llogarinë e shtetasës B në vendin e rezidencës X, në vlerë disa miliona EUR, një pjesë e të cilave janë përdorur për këto investime.

Duke marrë në konsideratë se transfertat nuk janë kryer nga vendi ku ka rezidencën apo aktivitetin e biznesit, AIF ka bashkëpunuar me NjIF partnere, ku jemi informuar se:

- Aktiviteti i shoqërisë B2, në vendin Z është çrregjistruar prej 2023;
- Shtetasi C, bashkëshorti i shtetasës B është i përfshirë në aktivitetet e të paligjshme që lidhen me krimin e organizuar.

Përveç kësaj, kjo shtetase së bashku me disa shtetas nga vendi i saj i origjinës kanë regjistruar shoqërinë Y në vitin 2019, me aktivitet në sektorin e hotelarisë dhe në fillim të vitit 2025 është larguar nga kjo shoqëri, me fitime të ulta.


Në konkludim të rastit, duke marrë në konsideratë elementët e mëposhtëm:

- Përdorimin e fondeve ndërkombëtare për blerje të pasurive të paluajtshme dhe veprave të artit në vlera të larta,
- Burimin e fondeve, të siguruar nga aktivitete biznesi me risk të shtuar,

- Dyshimet për përdorimin e kompanive të regjistruara në vende me lehtësira fiskale për fshehjen e origjinës së fondeve,
- Lidhjet familjare me individë të përfshirë në aktivitete kriminale të njohur,
- Përfshirja e disa juridiksioneve për qarkullimin e fondeve (vendi i rezidencës, vendi i urdhërimit të transfertave, vendet ku operon biznesi),

rasti u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Skema



Tipologji 4

Përdorimi i shoqërive të lidhura për qarkullimin e fondeve ndërkombëtare në sektorin marketing online

Njëmbëdhjete shoqëri të regjistruara në Shqipëri, kanë përfituar transferta në vlerë 3,740,000 EUR nga shtete të ndryshme në Europë dhe Azi.

Analiza e mëtejshme e këtyre shoqërive ka evidentuar lidhje ndërmjet tyre, të cilat konsistojnë në ushtrimin e aktivitetit në të njëjtën fushë, konkretisht në ofrimin e shërbimeve të marketingut online, si dhe në përfshirjen e të njëjtëve individë në role të ndryshme, si administratorë, ortakë apo persona me të drejtë përfaqësimi.

Një tjetër element i përbashkët i evidentuar lidhet me kohën e ushtrimit të aktivitetit, pasi këto subjekte janë regjistruar në vitin 2024 dhe për një periudhë gjashtëmujore apo brenda të njëjtit vit rezultojnë të jenë çregjistruar.

Duke marrë në konsideratë elementët e mësipërm, të cilët krijojnë dyshime mbi natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të këtyre subjekteve, AIF ka bashkëpunuar me organet tatimore.

Në vijim nga organi tatimor jemi informuar se disa nga këto shoqëri janë referuar në organet ligjzbatuese për veprat penale fshehje të ardhurash dhe mospagim i taksave e tatimeve.


Nga analizimi i aktivitetit bankar të 11 shoqërive janë identifikuar vendet nga ku janë përfituar transfertat me vëllimin më të lartë të fondeve dhe në vijim është komunikuar me NjIF partnere në 7 vende të ndryshme.

Nga informacioni i siguruar nga këto vende rezultuan disa anomali të lidhura me shoqëritë dërguese, konkretisht:

- Qarkullim fondesh shumë herë më i lartë nga deklarimi;
- Përdorim i llogarive të subjekteve për qëllime tranzitore, fondet transferohen drejt shteteve të ndryshme menjëherë pas kreditimit;
- Transferta jashtë profilit apo fushës së aktivitetit të subjektit dhe pa dokumentacion justifikues;
- Subjektet kanë zhvilluar aktivitet përgjatë së njëjtës periudhë me subjektet e regjistruara në Shqipëri dhe pjesa më e madhe e tyre janë çregjistruar,

Informacioni u dërgua për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Skema



Tipologji 5

Blerje pasuri të paluajtshme nga persona me precedent kriminal në fushën e narkotikëve

Shtetasi A ka kryer disa depozitime në llogarinë e tij në vlerën totale prej 50,000 EUR me burim të ardhura nga kursime si dhe ka përfituar transferta nga persona të tretë në formë huaje/dhuratë në vlerën totale prej 75,000 EUR.

Nga verifikimet e kryera për palët e treta rezultoi se nuk kanë marrëdhënie familjare me shtetasin A.

Gjithashtu, nga analiza e lëvizjeve financiare evidentohet se shtetasi A ka transferuar shumën prej 120,000 EUR në llogarinë e shtetasit B në një vend Evropian me qëllim blerjen e një pasurie të paluajtshme.

Nga verifikimet e mëtejshme rezulton gjithashtu se shtetasi A ka ndryshuar gjeneralitetet e tij dhe evidentohet si person me precedent penal në fushën e narkotikëve.


Duke marrë në konsideratë anomalitë si vijon:

- Dhënie huaje/ dhuratë nga palë të treta pa lidhje të evidentuara ndërmjet tyre;
- Transferim fondesh jashtë vendit për blerje pasuri të paluajtshme,

rasti u dërguar për investigim të mëtejshëm në organet ligjzbatuese.

Më tej jemi informuar se rasti është referuar në Prokurori për veprat penale fshehje e të ardhurave dhe pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

Skema



Tipologji 6

Investim në pasuri të paluajtshme nga ish zyrtar shtetëror i dënuar për shpërdorim detyre.

Shtetasi A, ish-punonjës në një institucion shtetëror, i dënuar për korrupsion dhe shpërdorim detyre, gjatë vitit 2024 ka nënshkruar kontrata sipërmarrje për prenotim pasuri të paluajtshme të llojit apartament në vlerën 60,000 EUR, poste parkimi në vlerën 35,000 EUR dhe njësi në vlerën 60,000 EUR.


Nga të dhënat në llogarinë bankare të shtetasit A rezultoi se fondet për blerjen e pasurive të paluajtshme janë akumuluar në llogari nga depozitime, transferta nga persona të tretë në vlerën 140,000 Eur, si: dhurim, dhënie hua, likuidim borxhi etj, me lidhje të paqarta mes palëve.

Duke marrë në konsideratë:

- Çmimin e ulët të blerjes së pasurive të paluajtshme nën vlerën e tregut;
- Strukturimin e pagesave në mbërritje nga persona të ndryshëm;
- Lidhje të paqarta mes palëve;
- Transferrat në llogari të përqendruara me qëllim përfitim të pasurive të paluajtshme si dhe dhënie huash,

rasti u dërguar për investigim të mëtejshëm në organet e zbatimit të ligjit.

Skema



Tipologji 7

Skemë mashtrimi me transaksione POS për përfitim financiar

Shoqëria Shqiptare X, e themeluar me fushë veprimtarie: “Import eksport e tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshëm ushqimorë dhe industrialë”, me administrator shtetas i huaj A, më datë 06.12.2024 ka krijuar marrëdhënie biznesi me një nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri.

Më datë 24.12.2024 ka vendosur në punë 2 POS dhe menjëherë ka kryer testime në të dyja терминаlet me një kartë të huaj të lëshuar nga një bankë në Belgjikës, me kartë mbajtës shtetasin Belg B.

Më datë 26.12.2024 shoqëria X ka kredituar llogarinë nëpërmjet POS, me kartën Belge në vlerën 96,000 EUR pjesën më të madhe të së cilës 83,000 EUR i ka tërhequr nga llogaria.


Më datë 31.12.2024 llogaria është kredituar sërish nëpërmjet POS, në vlerën 152,000 EUR dhe shoqëria X në të njëjtën datë, ka tentuar të kreditojë sërish shumën prej 790,000 EUR, por nuk ka arritur ta realizoj pasi transaksionet janë bllokuar nga Mastercard International.

Më datë 03.01.2025 Banka në Shqipëri është njoftuar nga Mastercard, pasi shoqëria ka tentuar të kalojë limitin e lejuar në kartë dhe kanë lindur dyshime për transaksionet me kartë, si rrjedhojë banka ka bllokuar llogaritë e shoqërisë X dhe menjëherë ka filluar procedurën “Charge back”.

Për kryerjen e transaksioneve me POS (të kryera dhe në tentativë), me vlerë totale rreth 1,000,000 EUR, shoqëria X i ka justifikuar nëpërmjet faturave tatimore, me vlera të njëjtë me transfertat, në favor të subjektit Y, me adresë në Belgjikë, në bazë të një marrëveshje të lidhur më datë 01.09.2024, midis shoqërisë Y, me përfaqësues shtetasin belg B dhe shoqërisë X ku citohet se: shoqëria X do t'i ofrojë shoqërisë Y, shërbime si: Eskortë; Makina me qira; VIP makina me qira etj., dhe vlera e shërbimeve të ofruara në total do të shkonte 2,500,000 EUR. Shoqëria X, një muaj para transfertave ka shtuar si pjesë të aktivitetit edhe shërbimin “Agjenci Turistike, Udhëtimesh”.

Nisur nga sa më sipër, duke marrë në konsideratë elementët e mëposhtëm:

- Marrja e fondeve me vlerë 1,034,688 EUR përtej limitit të lejuar në kartë, duke shfrytëzuar një dobësi të procesit të Automatizimit paraprak dhe më pas kalimi i tyre në llogarinë e shoqërisë X duke përdorur sistemin POS dhe jo transfertat bankare;
- Kryerja e transaksioneve në një kohë të shkurtë dhe gjatë ditëve të pushimit të Vitit të Ri;
- Shtimi i aktivitetit “Agjenci Turistike, Udhëtimesh” në objektin e veprimtarisë së shoqërisë shqiptare X, rreth një muaj para kryerjes së transaksioneve me qëllim justifikimin e transaksioneve të kryera,
- Ofrimi i shërbimeve të pretenduara të shoqërisë shqiptare X kundrejt asaj Belge Y, nuk përputhen me veprimtarinë që shoqëria X kryen në Shqipëri ndër vite, lindin dyshime se shoqëria shqiptare X, me administrator shtetasin e huaj A, në bashkëpunim me shoqërinë Y, me përfaqësues shtetasin B, janë përfshirë në një skemë mashtrimi, potencialisht edhe në shkelje të natyrës fiskale/tatimore, rasti u referua në organet ligjzbatuese për vlerësim të mëtejshëm.





fiu.gov.al



📍 Blvd. "Dëshmorët e Kombit", No. 3, Tiranë - Shqipëri

🌐 www.fiu.gov.al ✉ info@fint.gov.al

☎ +355 4 2 229 049